

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7360 E martë 21 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
Askush nuk e kishte menduar: Krijimi i qeverisë së ardhshme në Gjermani dështoi. Tani zhvillimet e tjera nuk dihen, flitet si për qeveri pakice ashtu ...
Vijon në faqen 21

Nga INES POHL
Gjermania e shokuar


Opinion i Ditës
Që modeli i sistemit të marrëdhënies ndërkombëtare ka ndryshuar që nga rrëzimi i komunizmit deri më sot, e dëshmon edhe mbushja me intensitet ...
Vijon në faqet 20-21

Nga VASIL KURETA
Nga një, në tre dhe rëndësia e marrëdhënies SHBA-Rusi-Kinë



Krimet e rënda lënë në burg biznesmenin
Dalin përgjimet, prokuroria: Dyshime se paratë janë të Tahirit

Iu gjetën patentat e ish-ministrit në makinë, çfarë tha me të atin, shoferin e kompanisë "Kurum" ...
Nga INA ALLKANJARI
Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për biznesmenin Orest Sota, i cili u arrestua pak kohë më parë pasi në makinë iu gjetën 863 mijë euro dhe dy patentat ...
Në faqen 7

KOMISIONI I EKONOMISE MIRATON PAKETEN FISKALE PER VITIN 2018, NDRYSHIMET TAKSA E BANESES, 90 MIJE FAMILJET QE PERJASHTOHEN

Tarifimi i ri sipas zonave, për shtëpitë 0.05 për qind, për bizneset 2 për qind. Qeveria vendos: Katër kategoritë që përjashtohen nga taksimi



(Në foto) Komisioni parlamentar i Ekonomisë

"FINANCIAL TIMES"
Narkotrafiku, Rama letër liderëve të 28 vendeve të BE: Na ndihmoni për drogën
Në faqen 3

FONDI SHITES
Dëmet e Zharrës, kush kompensohet me 172 milionë lekë për dëmet e tërmetit
Në faqen 16

"S'JEMI SKIFTERE"
Marshimi i "heshtur" i qindra fëmijëve në Kurbin, Vlahutin: Ligjet në letër nuk mjaftojnë
Në faqen 11

KENETA FAMEKEQE
E vërlta e masakrës së Maliqit, gruaja u vra shtatzënë, zbardhen dokumentet
Në faqen 15

DYSHIMET

Horror në Durrës, maskat dhunojnë barbarisht çiftin, policia e fsheh
Në faqen 12

50-vjeçari, kreu i grupit kriminal që u godit të shtunën, i dënuar për vrasje të dyfishtë në '99-ën
Jeta luksoze e tutorit të prostitutave, në Shkodër
Babai i dy fëmijëve shoqërohej me dy femra dhe postonte foto intime

Nga SENAD NIKSHIQI
Rinard (Frederik) Tota, i cili u arrestua të shtunën së bashku me 6 të tjerë për shfrytëzim prostitucioni, para pak muajsh bëri bujë në media dhe rrjetet sociale duke u bërë një emër i njohur



jo vetëm në Shkodër. Prej disa vitesh, 50-vjeçari posedonte lokalitë e tij "Tata", ku organizonte muzikë live, por edhe ofronte balerina për të kërcyer, për të kënaqur më shumë klientët. Ai është dënuar më parë disa herë, ndërsa së fundmi ...
Në faqen 13

KANABISI

DEBATI

Debati në mbledhjen e Grupit të PD-së për amnistinë e fshatarëve të thjeshtë

Valentina Madani

Propozimi i deputetit të PD-së Tritan Shehu për të amnistuar kultivuesit e thjeshtë të kanabisit provokoi dje debat në mbledhjen e Grupit Parlamentar të PD-së pavarësisht se kreu Lulzim Basha tentoi ta shmangte atë. Që në hyrje të mbledhjes, z.Basha i parapriu këtij debati duke e bërë që në fillim shpjegimin se z.Shehu ka shprehur një mendim personal dhe se PD-ja duhet të fokusohet te çështjet aktuale që i takojnë grupit parlamentar. "Faktet për krimin dhe drogën janë tronditëse, por duhet të sqarohet se propozimi i bërë nga z.Shehu është tërësisht personal dhe nuk është një vendimmarrje e partisë opozitare", -mësohet të jetë shprehur z.Basha. Por burime për "GSH" brenda mbledhjes bëjnë me dije se aleati i PD-së, kryerepublikani Fatmir Mediu e ka quajtur të pa pranueshëm një propozim të tillë duke thënë se ne jemi politikanë dhe nuk mund të flasim për propozime personale. "Ne jemi politikanë dhe qëndrimet e ligjvënësve demokratë duhet të jenë të konsultuara politikisht dhe jo personale për sa kohë gëzojnë mandat deputeti. Ndaj deklaratën e z.Shehu për amnistinë e kanabisit e konsideroj të papranueshme dhe që nuk duhet të marrë asnjë mbështetje". Është shprehur z.Mediu. Por për të shmangur një debat të mundshëm brenda mbledhjes mes Mediu dhe Shehut, z.Basha këmbënguli se qëndrimi i Shehut ishte krejt personal e duke lënë të kuptohet se nëse në të ardhmen do të kërkojë mbështetjen e grupit për një nismë ligjore, nuk do e ketë. I gjithë diskutimi u zhvillua pak kohë para se Tritan Shehu të ripërsëriste statusin e bërë në rrjetet sociale edhe një herë publikisht për mediat. Ai nuk dha detaje nëse propozimi i tij do të kthehet në të ardhmen në nismë ligjore, por, nëse ndodh, ajo që dihet me siguri është se firma e kryetarit të tij do të mungojë. Nga ana e tij z.Shehu edhe dje përsëriti se qëndrimi i tij është personal, por pa përjashtuar mundësinë që më vonë do të kërkojë nismë konkrete nga ana e PD-së.

SHITBLERJA

Kryedemokrati Lulzim Basha akuzoi dje qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama për shitblerjen e votës me 25 qershor ndërsa atakoi në mënyrë direkte kryebashkiakun e Durrësit Vangjush Dako. Në një deklaratë për

Kanabisi, Basha: Mendim personal i Shehut, Mediu: E papranueshme

"Qeveria bleu votat, shërbimet sekrete kapën Dakon"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

AKUZA

"Me grupet kriminale, shitblerja e votave u konfirmua nga raporti i OSBE-ODIHR. PD e ka ngritur me forcë problemin se Rama ka përdorur bandat e drogës në çdo qytet. Dako është kapur duke bashkëpunuar me grupet kriminale më të rrezikshme të Durrësit ku i kërkon të blejnë votat. Shërbimet inteligjente e kanë kapur gafil Dakon. Ai ju premtim tenderë kriminelëve, janë miliona euro, që ata të siguronin vota për PS", -tha z.Basha.



Forca të policisë gjatë një aksioni antikanabis

"Nuk më tremb kjo opozitë pulash"

Dako i përgjigjet Bashës: Gati të ballafaqohem

Kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako reagoi pas akuzave të kreu të PD-së, Lulzim Basha, i cili deklaroi se është nën hetim pasi është përgjuar me kriminelë dhe se Rama e mbron. Dako thotë se është i gatshëm të ballafaqohet në çdo studio apo shesh publik, për të gjitha ato që ai dhe altoparlantët e tij bërtasin për mua prej vitësh tashmë. E vetmja gjë që nuk bëj dot për Lulzim dhe partinë e tij është të fitojnë Durrësin, të cilin e kanë humbur thellë dhe më thellë, duke rënë poshtë dhe më poshtë në gropën që janë munduar të më hapin mua. Gjithë të tjerat me këtë lloj soji janë humbje kohe. Keqardhje për gjithë ata që dëgjojnë akoma Lulin dhe këtë opozitë pulash të lagura që bëjnë sikur janë ujë të tërbuar", -shkruan Dako.

mediat, ai theksoi se agjencitë inteligjente kane përgjuar Dakon në afëri me kriminelë, ku në këmbim të votave u ka premtuar tenderë. Sipas tij, Vangjush Dako u kap në flagrancë duke bashkëpunuar me grupet kriminale të Durrësit duke i ftuar të blejnë votat për PS në zgjedhjet e 25 qershorit. Sipas Bashës, vendet partnere e kapën gafil duke bërë pazare në telefon, ku në këmbim të votave, u premtim miliona euro, vetëm që ata të sigurojnë vota për PS. "Me grupet kriminale, shitblerja e votave u konfirmua

nga raporti i OSBE-ODIHR. PD e ka ngritur me forcë problemin se Rama ka përdorur bandat e drogës në çdo qytet. Vangjush Dako është kapur duke bashkëpunuar me grupet kriminale më të rrezikshme të Durrësit ku i kërkon të blejnë votat. Shërbimet inteligjente e kanë kapur gafil Dakon . Ai ju premtim tenderë kriminelëve, janë miliona euro, që ata të siguronin vota për PS. Këto pazare janë nën hetim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda", - deklaroi z.Basha. Më tej kreu i PD-së theksoi se "Me largimin e prokuror-

"Të përjashtuarit" me statut të ri, dorëzohet këtë javë në PD

Organizata e re e PD-së, Ende e pamiratur, shoqërohet nga një projekt-statut i ri, të hartuar nga anëtarë të Këshillit Kombëtar. "TCH" raportin se janë po ata anëtarë, që kundërshtuan publikisht listat për deputetë të kryetarit Basha, rezultatin e Partisë Demokratike në zgjedhjet e fundit dhe mënyrën se si u rizgjidh zoti Basha kryetar. Ky statut, që në pamje të parë ka të njëjtën arkitekturë institucionale me Partinë Demokratike sot, fut disa risi. Për shembull, projekt-statuti e ndan partinë sipas parimit të kontrollit dhe balancës së pushtetit, me pushtetin legjislativ (Kuvendin Kombëtar dhe Këshillin Kombëtar), ekzekutivin e partisë (kryesinë) dhe organet e pavarura: gjykatën, ko-



misionin e anëtarësisë dhe zgjedhjeve, si dhe bordin financiar. Organizimi i partisë në këtë mënyrë parashikon edhe një ulje të ndjeshme të numrit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar, nga 260 në 120. Kurse kryesia, nga 40 propozohet të bëhet me 25 anëtarë. Më pak anëtarë mendohej të bëjnë këto organe më efikase. Gjykata e partisë është parashikuar të jetë aty për të dhënë kujtdo mundësinë për të ankumuar vendimet e partisë. Një pro-

cedurë e posaçme mendohet të ndiqet për kandidaturat për deputet. Sigurisht, procedura e propozuar në këtë projekt-statut të ri nuk mban parasysh një rast urgjence, si ai i krizës politike të pranverës, që u zgjidh me marrëveshjen e 18 majit dhe ku u duk se demokratët nuk kishin shumë kohë për të përgatitur listat. Projekt-statuti i ri do t'i dorëzojë kryetarit Basha dhe Këshillit Kombëtar këtë javë. E vetmja mënyrë institucionale për ta marrë në shqyrtim projekt-statutit është Kuvendi. Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike duhet të mblidhet pas gati një viti. Deri atëherë, projekt-statuti pritet të jetë testi i kryetarit Basha në objektivin e shpallur prej tij, për të bashkuar partinë.

it të çështjes, Edi Rama po përpiqet të mbrojë Dakon dhe veten nga prangat e drejtësisë". "Për këtë arsye, ata ndërhyjnë fuqishëm për të larguar nga hetimi prokurorin që po e hetonte këtë aferë kriminale të interceptuar nga shërbimet inteligjente, përfshirë ato të vendeve partnere. Kjo është një nga çështjet ku mund të

gjendet edhe arsyeja e dorëheqjes së papritur të shefit të Shërbimit Inteligent. Për këtë arsye, Edi Rama përdor mënyrat e tjera për të shpëtuar Gjushin dhe Gjushët e tjerë të partisë. Ai, me presionin kriminal, ka larguar prokurorin Anton Martini nga hetimi i çështjes, i cili është "graduuar" drejtues në prokurorinë e

Shkodrës", -u shpreh z.Basha. Kreu i PD i kërkoj prokurorit të përgjithshëm të hetojë nëse lëvizja e Martinit është bërë nën presionin e Edi Ramës. "Prokurori që po heton vjedhjen spektakolare të votave në Durrës largohet me ngritje në Shkodër, me shpresën e vetme të Edi Ramës për të shpëtuar Gjushin nga prangat.



Kryeministri, në "Financial Times: Droga, kemi bërë përparim real

Narkotrafiku, Rama letër liderëve të 28 vendeve të BE: Na ndihmoni!

"Kjo është një betejë e të gjithëve e duhet fituar"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama u ka nisur nga një letër shpjeguese udhëheqëse të 28 vendeve anëtarë të Bashkimit Evropian, duke kërkuar mbështetjen e tyre në betejën e qeverisë shqiptare kundër drogës. Vetë Rama e bëri të ditur këtë nismë gjatë një shkrimit të botuar në "Financial Times".

"Ne kërkojmë ndihmën tuaj e në këmbim ofrojmë tonën, për t'i kapur këta njerëz dhe për t'i çuar përpara drejtësisë. Unë shpresoj që të gjithë qytetarët e vendeve të BE-së do t'u bëjnë thirrje qeverive të tyre për të qëndruar krahnesh. Kjo është një betejë e të gjithëve e duhet fituar", u ka shkruar kryeministri Rama liderëve të BE-së. Në opinionin e tij, publikuar në "Financial Times", Rama shprehet i vetëdijshëm se, "nëse përmend Shqipërinë, disa njerëzve u shkon menjëherë mendja te droga dhe krimi".

"Jam po ashtu i ndërgjegjshëm se fshirja e një imazhi të tillë, që është thellësisht i padrejtë për një vend me një popullsi kryesisht paqësore e që respekton ligjin, kërkon kohë e mbi të gjitha veprim. Javën e kaluar mësuam që aksioni ynë po korr frytë. I detyrohem policisë financiare italiane, Guardia di Finanza dhe mbikëqyrjes së sofistikuara që kryen ajo nga ajri për të zbuluar parcelat me kanabis për forcat policore shqiptare. Statistikat nuk lënë vend për dyshim", shkroi Rama në këtë artikull. "Një vit më parë, në fluturimet e tyre ata identifikuan 2 086 sipërfaqe të mbjella anëbanë Shqipërisë. Këtë vit, edhe pas fluturimeve të zgjatura e monitorimit të shtuar, numri i tyre ishte vetëm 88. Tashmë, të gjitha ato janë shkatërruar nga policia jonë. Ky është përparim real. I etiketuar për vitë si kryeqyteti evropian i kanabisit, Shqipërisë iu mbush kupa dhe ne nisëm të reagojmë", nënvizon me tej kryeministri. Duke përshkruar situatën që ishte deri para një viti, Rama shkruan më tej, "ne kemi nisur fazën e dytë të operacionit të posaçëm kundër tyre e parurive të tyre. Po pastrojmë sistemin gjyqësor duke verifikuar si duhet figurën e gjyqtarëve, të cilët për shumë gjatë janë drejtuar nga kriminelët dhe paratë e tyre. Megjithatë, këta kriminelë nuk veprojnë vetëm në Shqipëri. Ata janë të lidhur e të ndërlikuar me krimin e organizuar në vendet e kon-



Faksimile e letres së kryeministrit Rama



Kryeministri Edi Rama

REZULTATET

"Një vit më parë, në fluturimet e tyre ata identifikuan 2 086 sipërfaqe të mbjella anëbanë Shqipërisë. Këtë vit, edhe pas fluturimeve të zgjatura e monitorimit të shtuar, numri i tyre ishte vetëm 88. Tashmë, të gjitha ato janë shkatërruar nga policia jonë".



PS do të shpallë vendin bosh për KQZ

Mazhoranca, plan për shkarkimin e Klement Zgurit më 30 nëntor

Mazhoranca pritet të shkarkojë zyrtarisht kreun e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Klement Zguri. Burimet nga PS bënë me dije se në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, që mendohet të mblihdet para seancës parlamentare të datës 30 nëntor, do të kërkohet pikërisht shkarkimi i Zgurit, pas kërkesës që PS i ka dorëzuar kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçi. Këtë të enjte Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nuk do të mblihdet ashtu si zakonisht, për t'ia lënë gjithë kohën e nevojshme datës 30 nëntor, kur do të kalojë nën për nën buxheti i vitit 2018. Duket se gjatë kësaj seance mazhoranca do t'i shkojë deri në fund iniciativës së nisur për shkarkimin e kreut të KQZ-së, Klement Zguri. Zguri do të shkarkohet edhe si anëtar i KQZ-së, i akuzuar nga PS për shkelje të Kodit Zgjedhor dhe ligjit të dekriminalizimit. Më pas do të shpallet vendi i lirë për kryetar të KQZ-së. Ndërkohë, me anëtarin e ri të KQZ që do të zgjidhet si kryetar në vend të Zgurit, PS merr shumicën edhe në këtë institucion. Partia Socialiste e akuzon Zgurin se ka shkelur ligjin e dekriminalizimit, pasi nuk i hoqi mandatin kryebashkiakut të Mallakastrës, Agron Kapllanaj, i cili rezultoi i dënuar me dy vjet heqje lirie në Itali më 2004. Pas kësaj, kreu i KQZ, i emëruar në kuadër të marrëveshjes politike të 18 majit mes Ramës dhe Bashës, ka humbur besimin e socialistëve.

Kreu i grupit të LSI, kritika kryeministrit: Shembull i shëmtuar

Vasili: Rama, mashtrues publik, deklaroi se e eliminoi drogën

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, duke komentuar letërën e kryeministrit Edi Rama, drejtuar homologëve evropianë për të luftuar kanabisin, tha se kërkesa për ndihmë vjen ndërkohë që kryeministri gënjej banalisht se e fitoi luftën ndaj këtij fenomeni.

"Kryeministri i Shqipërisë është shndërruar në shembullin më të shëmtuar të mashtruesit publik. Nuk ka vulgaritet e banalitet pa nxjerrë nga goja kundër çdo partie, individi, media të të gjitha llojeve shqiptare e ndërkombëtare, që flasin për drogën dhe efek-



tin shkatërrimtar të saj për Shqipërinë dhe shqiptarët", u shpreh dhe Vasili. "Nuk ka gënjeshtëri, manipulim faktesh, ngjarjesh e raportesh për të mohuar, mbuluar dhe përdorur për pushtetin e tij

dhe për të blerë vota, këtë tragedi politike e sociale", tha më tej deputeti i LSI-së. Sipas tij, "sot po ky kryeministër u dërgon letër shteteve evropiane për ndihmë për drogën, që po ky me demokracië e kishte 'eliminuar' 99%". Ja ç'thoshte ky kryeministër jo më larg se 2 javë më parë dhe kuptoni më mirë çdo të thotë gënjeshtar, që as skuqet, as zverdhët. Ja ç'thoshte kryeministër: "Ne e fituam betejën me kanabisin. Viti 2017 e nxori vendin nga harta e zezë. Vetëm qorrat që nuk duan të shohin, shurdhë të dëgjojnë, apo kazonë që nuk duan të mësojnë", deklaroi Vasili duke cituar Ramën.

sumit të kanabisit dhe qeveritë e këtyre vendeve duhet po ashtu të mbajnë pjesë të përgjegjësisë për t'i çuar ata përpara drejtësisë", shprehet Rama. "Në javët e muajt në vijim, ne do të ndajmë ato që dimë dhe provat që kemi kundër tyre me forcat policore e rregullatorë financiare në të gjithë Evropën. Ata janë njerëz të rrezikshëm. Qeveria ime i konsideron si kërcënim ndaj sigurisë kombëtare. Të njëjtë prej tyre jetojnë diku gjetkë në Evropë, duke pretenduar se janë tregtarë të ligjshëm, por mos u gaboni, ata janë kriminelë, bizneset ndërkombëtare të cilëve skllavërojnë njerëz e

bëjnë kërdinë kudo", theksoi kryeministri. Duke folur për reformën në drejtësi, Rama vijon më tej: "Reforma e sistemit tonë të drejtësisë dhe rivlerësimi i gjyqtarëve e prokurorëve për korruption e paafësi - kushte kryesore të vendosura nga Bashkimi Evropian përpara sësë të hujmë në negociatat formale për anëtarësim - gati devijoi në fillim të këtij viti. Interesa vetjake kundër reformës sollën trazira në rrugë dhe herë-herë dukeshin të vendosura ta vinin në rrezik demokracinë tonë të re. Vlen të kujtojmë se për 20 vjet baronët e drogës qenë në gjendje ta mbanin zonën rreth fshatit shqiptar të Lazaratit si strehë të sigurt të prodhimit

dhe përpunimit të kanabisit, një zonë ndalim-kallimi për policinë dhe autoritetet e tjera qeveritare. Kaq i madh ishte pushteti i tregtisë së drogës, sa që një paraardhës i imi kryeministër e pranoi se mosndërhymja në zonë ishte të "vendim i palëkundur politik" i tij. Qeveria ime e përmbysi këtë politikë në vitin 2014 dhe një operacion madhor policor e mbylli Lazaratin", shkroi Rama. Policia shkatërroi një "produkt" që përbënte afro një të katërtën e kanabisit të konfiskuar e shkatërruar në mbarë Shqipërinë gjatë atij viti. Ky ishte fillimi i luftës sonë kundër banditëve. Tashmë, na duhet të ndërmarim një tjetër hap të rëndësishëm", tha Rama.

INTERVISTA

ONM

Ani Ruci

Vetingu lidhet me të ardhmen e qenieve njerëzore dhe duam të jemi të sigurt që e gjithë puna që po bëjnë institucionet është shumë rigorozë, e ndershme dhe e ekuilibruar", deklaroi dje, për "DW"-në Genoveva Ruiz Calavera, kryetare e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për vetingun e gjykatësve dhe të prokurorëve të Shqipërisë dhe drejtore për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian për Fajinësë dhe Negociatave e Zgjerimit. Gjatë kësaj interviste, Calavera tha se, "procesi i vetingut në përgjithësi po shënon progres dhe është në drejtimin e duhur". Ajo nuk pranoi të vendosë afate për realizimin e plotë të vetingut, duke e krahasuar atë me procesin e integritetit evropian. E pyetur nëse kanë hasur pengesa për mbështetjen që po i bëjnë vetingut, Calavera tha: "Rezistencën e kemi hasur që në fillim të procesit. Kryetarja jonë e delegacionit të BE-së në Tiranë ka qenë subjekt fushatash denigruese, shpifjesh dhe sulmesh totalisht pa asnjë bazë. Jam realiste që vetingu do të prekë interesa financiare të individëve që janë pasuruar padrejtësisht dhe nuk do të jetë një proces i qetë. Pres lajme të rreme, gjysmë të vërteta, fushata shpifjesh, sulmesh denigruese ndaj meje, por jam e përgatitur t'i përballoj".

Znj. Ruiz Calavera, si po ecën procesi i vetingut? Jeni e kënaqur me ritmet e tij?

Procesi i vetingut në përgjithësi po shënon progres dhe është në drejtimin e duhur. Ai është shumë i rëndësishëm, pasi është i lidhur me skanimin e së ardhmes së njerëzore dhe duhet kryer me shumë seriozitet dhe rigorozitet për të siguruar një ecuri sa më të mirë në procesin e hyrjes së Shqipërisë në BE. Institucionet e vetingut, të ngritura në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë duhet të marrin përgjegjësi të tyre për të shënuar progres dhe për të vendosur atë fort në shinat e duhura, përpara vlerësimit të kontekstit të Shqipërisë, në dritën e hapjes së negociatave të anëtarësimit në BE. Jam shumë e kënaqur që operacionet e vetingut kanë filluar dhe që së bashku me progresin në pesë prioritetet kyçe, do të hapin derën për hapin tjetër që do të hedhë Shqipëria në procesin e integritetit evropian. Nuk dëshiroj të them

Kryetarja e ONM-së: Kemi hasur rezistencë që në fillim të procesit

Vetingu, Genoveva Ruiz Calavera: Dëshirojmë cilësinë para shpejtësisë

Prokurorët e "Tahirit": Të gjithë do të kalojnë në skaner



Genoveva Ruiz Calavera, kryetare e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit

se kur do të ndodhë kjo: në pranverën apo verën e ardhshme, pasi varet vërtet nga progresi në procesin e vetingut dhe 5 fushat prioritare. Por dëshiroj të them që pres me padurim të shoh progres në kontekstin e vetingut, që ai të funksionojë mirë për të demonstruar se po kryhet dhe po kryhet në standardet më të larta të mundshme.

Sa kohë mund të marrë pak a shumë vetingu për të skanuar rreth 1000 gjyqtarë dhe prokurorët të Shqipërisë?

Nuk dëshirojmë të vendosim afate artificiale, pasi procesi i vetingut i ngjan pak atij të anëtarësimit në BE. Dëshirojmë cilësinë para shpejtësisë. Është një proces kaq i rëndësishëm, sa që kërkohet vlerësimi i vlerësimit në thellësi të ?do gjyqtari dhe prokurori. Flasin për të ardhmen e qenieve njerëzore dhe duam të jemi të sigurt që e gjithë puna që po bëjnë institucionet e vetingut është shumë rigorozë, shumë e ndershme dhe e ekuilibruar. Koha sesa do të zgjasë varet nga rastet konkrete. Mund të ketë rastet e tjera, të ndërlikuara nga pikëpamja e aksesit në informacion, do të ketë dëgjesa pasi njerëzit kanë të drejtën të shprehin, do t'u jepet mundësia për të sjellë prova dhe dëshmi. Për ne nuk është e rëndësishme që

procesi i vetingut të përfundojë, që Shqipëria të kalojë në fazën tjetër në procesin e anëtarësimit në BE. Për ne është e rëndësishme që procesi i vetingut të kryhet si duhet. Pra, e rëndësishme është që nuk kemi nxitim për t'u siguruar që do të merret opinioni për hapjen e negociatave, pasi e rëndësishme është të bëjmë gjënë e duhur. Kjo është garancia e një procesi të ndershmë, jam e bindur që shumë gjykatës dhe prokurorë do ta kalojnë vetingun pa vështirësi, nuk dua të stigmatizoj të gjithë sistemin gjyqësor, ka profe-

AFATET

"Nuk dëshirojmë të vendosim afate artificiale, pasi procesi i vetingut i ngjan pak atij të anëtarësimit në BE. Dëshirojmë cilësinë para shpejtësisë. Është një proces kaq i rëndësishëm, sa që kërkohet vlerësimi i vlerësimit në thellësi të ?do gjyqtari dhe prokurori", u shpreh Calavera.

sionistë shumë të mirë. Por në të njëjtën kohë do të jemi të aftë të identifikojmë "mollët e kalbura të sportës", ata që nuk do ta kalojnë testin e vetingut. Pra, do të hapet një hapësirë për gjykatës dhe prokurorë të rinj, që vijnë me qëndrime dhe pikëpamje të tjera për profesionalizimin, integritetin, pavarësinë dhe efikasite-

PROKURORËT
"Ne shpresojmë fort që në fund të procesit do të jemi të aftë të identifikojmë gjykatësit dhe prokurorët e lidhur me krimin e organizuar. Procesi në vetvete është për t'i skanuar dhe nxjerrë ata nga sistemi i drejtësisë. Vetingu nuk i fut në burg, por pasoja e vetingut do të jetë që ndaj tyre të fillojnë hetime dhe ngrihen akuzat", tha Calavera.

tin. Duam që sistemi gjyqësor të bëjë drejtësi në mënyrë të ndershme për të gjithë qytetarët e Shqipërisë dhe të jetë efikas.

Rasti i ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, që po hetohet si i dyshuar për korrupsion dhe lidhje me trafikantët të drogës, mund të jetë sipari i një drejtësie të tillë. A mund të ?ojë procesi hetimor në fjalë në një drejtësi, gjykim të ndershmë kur prokurorët e Tahirit nuk e kanë kaluar testin e vetingut?

Të gjithë prokurorët do

sistemi i drejtësisë. Vetingu nuk i fut në burg, por pasoja e vetingut do të jetë që ndaj tyre të fillojnë hetime dhe ngrihen akuzat. Roli im është që vetingu, skaneri të bëhet në mënyrë të ndershme dhe të pavarur nga ndërhyrjet politike.

Çfarë hapësirash pritet të krijojë vetingu për politikanët dhe zyrtarët e lartë të administratës publike të përfolur në media apo debate publike me kundërshararët politikë për pasurim të paligjshëm, abuzim me postin, korrupsion, lidhje me krimin e organizuar?

Kur të kemi një gjyqësor të ri, ku gjyqtarët do të kenë standarde më të larta profesionale, pa marrëveshje të fshehta me krimin e organizuar apo ndikime nga politikanët, atëherë ata do të jenë mjaft të lirë dhe të pavarur për të ndërmarrë hetime ndaj kësajopolitikanësh. Kjo është fryma e vetingut, të krijojë një hapësirë për një sistem gjyqësor profesional, të përgjegjshëm ndaj qytetarëve, të pavarur dhe efikas.

Çfarë garancish ka që në fund të tunelit ka dritë? Dhe që ajo po afrohet?

Nuk do të harxhohim kaq shumë fonde nga buxheti i BE, kaq shumë energji dhe kaq shumë nga kredibiliteti ynë, nëse nuk do të mendonim që do arrinin atë që presim në fund të procesit: kushte më të mira për gjykatësit për të bërë punën e tyre në standarde të larta, që sjell si pasojë shumë rezultate në luftën kundër kriminit të organizuar, korrupsionit dhe sigurisht një drejtësi shumë më të ndershme se deri tani dhe zbatim rigoroz të ligjit.

A prisni rezistencë ndaj një kthese të tillë historike në Shqipëri, së cilës, ju po thoni, do t'i hapë rrugën vetingu?

Rezistencën e kemi hasur që në fillim të procesit. Kryetarja jonë e Delegacionit të BE-së në Tiranë ka qenë subjekt fushatash denigruese, shpifjesh dhe sulmesh totalisht pa asnjë bazë. Jam realiste që vetingu do të prekë



Delegacioni shqiptar, dje në Parlamentin Evropian për situatën në Shqipëri

interesa financiare të individëve që janë pasuruar padrejtësisht dhe nuk do të jetë një proces i qetë. Pres lajme të rreme, gjysmë të vërteta, fushata shpifjesh, sulmesh denigruese ndaj meje, por jam e përgatitur t'i përballoj. Vetingu është një proces që duhet mbrojtur, ai nuk është një 'show'. Duhen mbrojtur institucionet e vetingut që të bëjnë punën e tyre. Kam shumë besim se gjykatësit ndërkombëtarë që kemi janë të aftë të japin ndihmesën e tyre. Roli i tyre është të jenë vëzhgues të pavarur, por mund të japin këshilla shumë të mira sesi duhen bërë gjërat, nisur nga përvoja e pasur. Janë gjyqtarë të nivelit të lartë, shumë të përkushtuar ndaj Shqipërisë dhe besoj fort se janë krijuar kushtet për të bërë punën. Por, nuk jam naive për vështirësitë që do hasim për t'i shkuar deri në fund procesit. Por do të përpqemi të bëjmë më të mirën tonë që asistencën jonë në monitorimin e procesit të jetë në standardet më të larta të mundshme. Shqiptarët e meritojnë këtë proces. Kjo që po bëjmë nuk është sepse e kërkojmë politikanët, por sepse e duan qytetarët e Shqipërisë. Është një përgjegjësi dhe nder i madh që po bëjmë këtë punë. Dua të falënderoj shqiptarët për kurajën që flasin hapur dhe kërkojnë ndryshimin. Kjo është mënyra e vetme për të bërë të përgjigjshëm politikanët dhe institucionet të bëjnë punën e tyre. Dëshiroj t'u kërkoj shqiptarëve të jenë të duruar, pasi procese të tilla nuk bëhen brenda natës, të transformosh sistemin gjyqësor kërkohet kohë. Shqiptarët nuk duhet të humbasin shpresën dhe besimin që kjo do të ndodhë. Ata duhet të vazhdojnë ta kërkojnë ndryshimin, të flasin hapur se kjo është ajo që ata duan. Kjo na jep forcë për të vazhduar.



Tryeza në Bruksel, Spaho: Zgjedhjet e lira dhe jo të blera, parakusht për në BE

Negociatat, Balla: BE do të vendosë shumë shpejt për Shqipërinë

LSI: Evropa të flasë për shitblerjen e votës

Valentina Madani

Mazhoranca dhe opozita shprehen qëndrime të kundërta dje në Parlamentin Evropian për situatën aktuale në Shqipëri. Opozita përmes demokratit Edmond Spaho dhe zyrtarit të LSI-së, Petrit Vasili akuzoi qeverinë për lidhje me krimin dhe blerjen e votës, ndërkohë që mazhoranca përmes Taulant Ballës foli për progres dhe vendim të shpejtë të BE-së për hapjen e negociatave me vendin tonë. Nga Brukseli, kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, i cili kryeson delegacionin shqiptar dha lajmin e mirë lidhur me vendimin që do të marrë së shpejti Bashkimi Evropian për negociatat me vendin tonë. I pranishëm në tryezën e nivelit të lartë mbi procesin e integritetit evropian të Ballkanit Perëndimor, kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla deklaroi sot, se BE do të marrë së shpejti një vendim sa u përket negociatave me qeverinë tonë për anëtarësim. "Bashkimi Evropian do të marrë së shpejti një vendim mbi axhendën e negociatave me qeverinë tonë drejt anëtarësimit të Shqipërisë në familjen europiane. Ky është një hap, të cilin shqiptarët, pavarësisht bindjeve apo përkatësive politike, e kanë prituri për më shumë se dy dekada. Edhe prezenca e tre kryetarëve të grupeve më të mëdha politike në Kuvendin e Shqipërisë e konfirmojnë këtë mbështetje për hapjen sa më shpejt të negociatave", u shpreh Balla. I shoqëruar nga Edmond Spaho, Petrit Vasili dhe Evis Kushi si pjesë e delegacionit shqiptar, Balla theksoi se shenjë e progresit të Shqipërisë është edhe miratimi i disa reformave të rëndësishme, siç është edhe vetingu. Sipas Ballës, shumë shpejt do të ketë edhe rezultate konkrete me emra gjyqtarësh e prokurorësh. "Një vit më parë, Komisioni Evropian rekomandoi hapjen e negociatave me Shqipërinë në vlerësim të progresit në përmirësimin e prioritetve kyçe dhe në varësi të progresit të prekshëm dhe të besueshëm të reformës në drejtësi, në mënyrë të veçantë, rivlerësimin (veting) i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Unë e falënderoj Komisionin Evropian për angazhimin dhe për mbështetjen që po i jep implementimit të procesit të vetingut. Shumë shpejt do të kemi rezultate konkrete, me emra konkretë gjyqtarësh dhe prokurorësh", deklaroi z.Balla.



DENONCIMI

Deputeti i PD-së, Klevis Balliu ishte dje në Bruksel në një takim për rininë dhe politikën, ku ishte i pranishëm edhe zëvendës-presidenti i PE-së. Balliu tha se ka kërkuar në Bruksel mbështetjen e BE-së në luftën kundër drogës, ndërsa ka theksuar se rinia nuk ka besim të politika, për shkak të lidhjes së qeverisë me krimin.

Këshilli Shqiptari-BE, PD kërkon sqarime pse mbeti jashtë

Komisioni parlamentar i Integritetit u shoqërua dje me debata mes anëtarëve të majtë dhe të djathtë. Kryetari i komisionit, Genc Pollo, akuzoi se u prish tradita e mirë në mbledhjen e Këshillit të Stabilizim Asociimit. Po ashtu, edhe anëtarët e djathtë, Jorida Tabaku dhe Aldo Bumçi ngritën shqetësimin e përjashtimit të opozitës nga angazhimet ndërkombëtare. Përveç sqarimeve nga qeveria, opozita kërkon edhe që përfshirja e opozitës në përfaqësimin para BE-së të kthehet në një detyrim ligjor. "Në procesin e integritetit nuk ka pronarë, nuk përfiton njeri politikisht. Procesin e integritetit, PD e ka pasur prioritet jo të saj e për merita politike, por duke vendosur në rend të parë përfitimin e qytetarëve. Për këtë arsye është vendosur gjithmonë opozita, në çdo vendim e udhëtim. Ajo që ndodhi javën e shkuar, që u përpoq që zëri i opozitës të shuhet ishte e paprecedentë. Ndaj kemi përgatitur këtë deklaratë, që në thelb ka kërkimin e shpjegimit nga kryeministri dhe ministri Bushati dhe angazhimin për përfaqësimin e opozitës", ka thënë Jorida Tabaku, deputete e PD-së. Nga ana tjetër, Blendi Çuçi kërkoi që të diskutohet për rendin e ditës, duke thënë se kjo duhet të jetë hera e fundit që devijohet nga rrjedha normale e diskutimit. Deputetët e PD në Komisionin e Integritetit dorëzuan një kërkesë, duke kërkuar shpjegime për kryeministrin Rama dhe ministrin Bushati për përjashtimin e opozitës nga mbledhja e këshillit. Në komunikimin e bërë në komision nga deputeti demokrat, Genc Pollo, theksohet se opozita duhet të jetë pjesë e proceseve integruese të vendit.

PËRJASHTIMI I OPOZITËS NGA KSA, DEBATET TEK "INTEGRIMI"

POLLO: U prish tradita e mirë në mbledhjen e Këshillit të Stabilizim Asociimit. Kërkojmë angazhime që kjo të jetë detyruese.
ÇUÇI: Të mos dalim nga rendi i ditës. Në fund merrmë me çështje jashtë rendit të ditës.
TABAKU: PD ndoqi me shqetësim faktin që opozita nuk u përfaqësua në Komisionin e Stabilizim Asociimit. Në procesin e Integritetit nuk ka pronarë. Ne kemi përfshirë gjithmonë opozitën. Ajo që ndodhi javën e kaluar ishte e paprecedentë për të shuar zërin e opozitës në Bruksel. Kërkojmë shpjegime nga kryeministri dhe ministri i Jashtëm për këtë çështje. Nuk doni që droga e krimi të bëhen objekt diskutimi në tryezat ndërkombëtare. Në këtë proces nuk ka përfutjes politike.
ÇUÇI: Të jetë hera e fundit që devijojmë nga rrjedha normale. Ka qenë traditë e mirë pjesëmarrja e opozitës, por fakti që nuk erdhin asnjë kësaj radhe, ishte sepse nuk që asnjë nga Parlamenti, por vetëm ministri i Jashtëm. Le të kërkojmë atij informacion se pse përdorën këtë format.
BUMÇI: PD i ka themeluar këto tradita të mira. Ne ia dhëm opozitës të drejtën e pjesëmarrjes në këto formate. Ne e ftuam Bushatin si përfaqësues i opozitës në vitin 2011 të vitin në tryezë. Është për të ardhur keq që vetë ai ia heqë këtë të drejtë opozitës.

Denoncimi te Berisha, "Tahiri mashtroi, babai i tij nuk ishte në Gjermani"

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një denoncim në lidhje me largimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri nga Shqipëria. Në faqen e tij në "Facebook", Berisha shkruan se Tahiri ka mashtruar drejtësinë dhe parlamentin. Duke iu referuar oficerit dixhital, Berisha shprehet se Tahiri ka qëndruar në Gjermani nga data 17 deri në datën 20 nëntor dhe se gjatë kësaj kohe babai i tij ka qenë në Shqipëri. Ndërkohë që pas publikimit të lajmit për daljen e ish-ministrit nën hetim, u tha se kishte shkuar në Gjermani për arsye familjare, duke iu referuar problemeve shëndetësore të babait të tij. "Saimir Trafiku ka mashtruar drejtësinë dhe parlamentin! Oficeri dixhital denoncon mashtrimin kriminal të Saimir Trafikut për motivin e largimit të tij në Gjermani në kundërshtim dhe thyerje flagrante të Kushtetutës dhe vendimit të parlamentit. Sipas tij, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, Saimir Trafiku ka qenë në Gjermani nga data 17 deri më datën 20 nëntor dhe po sipas sistemit TIMS, Bashkim Tahiri në këto data nuk ka qenë fare në Gjermani, por vetëm në Shqipëri. Edhe njëherë bëj thirrje t'i hiqet menjëherë mandati këtij trafikanti gangster. Lexoni mesazhin e oficerit dixhital! SB 'Përsëritet Doktor. Sipas sistemit TIMS, Saimir Tahiri ka qenë në Gjermani nga data 17 deri 20 nëntor. Por në këtë kohë babai i tij, Bashkimi ka qenë në Shqipëri e jo në Gjermani, siç deklaroi ai", thuhet në mesazhin dërguar z.Berisha.



OPOZITA

Përfaqësuesi i PD-së në tryezën e Brukselit, z.Edmond Spaho vuri theksin në luftën ndaj krimin dhe lidhjeve të tij me qeverinë gjatë fjalës së mbajtur në konferencën e organizuar nga Parlamenti Evropian: Perspektiva rajonale e procesit të integritetit evropian për vendet e Ballkanit

Perëndimor. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Spaho shkruan: "Atje theksova nevojën e luftës ndaj krimin të organizuar e lidhjet e tij me mazhorancën aktuale në Shqipëri si dhe nevojën për zgjedhje të lira e të ndershme pa votë të blerë e të trafikuar, si parakushte për rrugëtim të sigurt në Bashkimin Evropian dhe ku Parlamenti Evropian mund të bëjë shumë. Theksova gjithashtu nevojën që Kosovës t'i jepet liberalizimi i vizave, pasi jo vetëm janë plotësuar kushtet, por një popull nuk mund të lihet si ishull i izoluar pa të drejtë për të lëvizur i lirë në BE". Nga ana e tij, kreu i deputetëve të LSI-së, Petrit Vasili, i pranishëm në Bruksel vuri në dukje se Evropa nuk duhet të heshtë më, por duhet të flasë në mënyrë direkte për zgjedhjet e blera, trafikun e drogës dhe krimin e organizuar. "Duhet vënë detyra të qarta që të mund të monitorohen, ashtu si u veprua për liberalizimin e vizave. Shqiptarët besojnë tek integrimi evropian, por jo sa më parë", tha Vasili. Sipas deputetit të LSI-së, inkurajimi i Europës për ne është pozitiv, por nuk duhet të jetë bashkëjetesë me problemet e rënda të qeverisë që po e bëjnë integrimin një ëndërr të parralizueshme. "Të gjithë duam një integrim evropian sa më të shpejtë, por duam edhe një integrim me përmbajtje dhe të merituar. Nëse Evropa nuk do të jetë e prerë në zgjidhjen e problemeve që kanë tronditur shoqërimin shqiptar, do të mbetet një të dera e Europës, pa hyrë kurrë në të", theksoi z.Vasili.

Maqedoni, Presidenti i Shqipërisë pritet nga zyrtarët e lartë të shtetit



Dezertimi i 4 komandëve, ambasada britanike: Veprime zhgënjyese individuale

Katër komandot e Forcave të Armatosura, Ylber Tokrri, Aleksandër Shkulaku, Klevis Lamkaj dhe Reni Ajazi do t'i nënshtrohen një gjyqi ushtarak në rast se arrestohen në Britani, vend ku qëndruan pas mbarimit të një trajnimit. E kontaktuar nga "BalkanWeb", Ambasada Britanike i cilëson kryetësit individuale veprimet e komandëve dhe sqaron se një gjë e tillë nuk do ndikojë marrëdhëniet e Mbretërisë së Bashkuar me FA. "Këto janë veprime individuale dhe që sado zhgënjyese, nuk ndikojnë marrëdhënien e fortë e të vazhdueshme mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë", thuhet në reagimin e ambasadës britanike për BalkanWeb. Kujtojmë se Ministria e Mbrojtjes pas këtyre veprimeve ka bërë kallëzim penal në Prokurori, e cila ka nisur procedimin penal ndaj tyre dhe ka nxjerrë urdhër-ndalimet që i janë dërguar autoriteteve në Britaninë e Madhe. Pas ndalimit atje, në bazë të marrëveshjes mes dy vendeve, do të ekstradohen në Shqipëri, ku rrezikojnë të dënohen nga 1 deri në 5 vjet burg për shkelje të betimit dhe mosparaqitje tek eprorët.

Meta, Ivanovit: Nëse i gjykojmë njerëzit, nuk mbetet më kohë për t'i dashur ata

"Ballkani ka nevojë për bashkëpunim konkret, jo retorikë"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta u takua dje, gjatë vizitës së tij zyrtare në Maqedoni me homologun e tij, Presidentin Gjorge Ivanov. Në takimin që patën kokë më kokë Presidenti Meta vlerësoi lidhjet e ngushta historike e kulturore dhe theksoi se ato janë ekzistenciale dhe përcaktuese për të ardhmen evropiane të dy vendeve tona. "E vetmja mënyrë për të përballuar sfidat e globalizimit është bashkëpunimi i ngushtë në nivel dypalësh dhe atë rajonal", - u shpreh Presidenti Meta. Në mënyrë të veçantë Presidenti Meta vlerësoi frymën dhe vizionin e përbashkët euroatlantik që i karakterizon ato dhe duke përhëndetur zhvillimet dhe angazhimet e marra nga qeveria e re e Maqedonisë, për përmirësimin e klimës dhe harmonisë ndëretnike. Në mënyrë të veçantë, Presidenti Meta, vlerësoi hapat konkrete në drejtim të miratimit të ligjit për përdorimin e gjuhës shqipe. Presidenti Meta i konsideroi shqiptarët në Maqedoni, një faktor të rëndësishëm për stabilitetin dhe zhvillimin e vendit dhe të orientuar qartë drejt BE-së dhe NATO-s, ndërsa pakicën kombëtare maqedonase në Shqipëri, si urë lidhëse të fuqishme miqësie. Presidenti Meta shprehu besimin se ligji i ri për pakicat kombëtare në Shqipëri do të krijojë hapësirë e duhur për ruajtjen e identitetit të saj sipas standardeve më të mira evropiane. Duke përfiruzuar Nënë Terezën, e cila i bashkon të dy vendet, Presidenti Meta theksoi se shprehja e saj: "Nëse i gjykojmë njerëzit pa fund nuk mbetet më kohë për t'i dashur ata"; i shërben si njerëzve ashtu edhe fqinjëve. Sa i përket bashkëpunimit dypalësh, Presidenti Meta nënvizoi domosdoshmërinë e zhvillimit të projekteve të përbashkëta, veçanërisht në fushën e infrastrukturës lidhëse mes dy vendeve dhe shprehu besimin se, mbledhja e ardhshme e dy qeverive në Pogradec, do t'i japë një shtytë marrëdhënieve dypalëshe, jo vetëm në planin politik, por edhe në atë ekonomik dhe do të evidentojë projektet e përbashkëta në kuadër të procesit të Berlinit. "Ballkani, i cili ka prodhuar shumë histori e retorikë konfliktuale në të shkuarën, sot ka shumë nevojë për bashkëpunim konkret dhe jo retorikë bashkëpunuese", theksoi Meta. Presidenti Meta e siguroi edhe njëherë Presidentin Ivanov për mbështetjen e Shqipërisë për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe rëndësinë që ka për stabilitetin dhe sigurinë në rajonin e Ballkanit. Po dje, Presidenti shqiptar u prit edhe nga Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev. "Marrëdhëniet



Presidenti i Republikës, Ilir Meta dhe, gjatë takimit me homologun e tij, Presidentin Gjorge Ivanov

e mira ndëretnike në Maqedoni janë shumë të rëndësishme, jo vetëm për stabilitetin e Maqedonisë, por edhe për stabilitetin e të gjithë rajonit", - u shpreh Presidenti Meta. "Së bashku mund t'i rezistojmë e të përballojmë me sukses të gjitha sfidat e globalizimit me të cilat përballlet rajoni ynë", - u shpreh

Presidenti Meta. Presidenti Meta dhe Kryeministri Zaev ndanë të njëjtin mendim lidhur me domosdoshmërinë e rritjes së bashkëpunimit ekonomik e tregtar, si dhe përmirësimin e lidhjeve energjetike dhe infrastrukturës, ku padyshim zbatimi i projekteve të përbashkëta në kuadrin e



Presidenti i Republikës, Ilir Meta dhe, gjatë takimit me kryeministrin Zoran Zaev

Korridorit 8 është shumë i rëndësishëm. Ata shprehën besimin se në takimin e ardhshëm mes dy qeverive, në Pogradec, do adresohen të gjitha këto çështje që lidhen me nxitjen dhe zhvillimin e gjithanshëm mes dy vendeve. Gjatë takimit me kryetarin e Asamblesë, Talat Xhaferi, Presidenti Meta inkurajoi

kryeparlamentarin Xhaferi për të qenë më kontribues për bashkëjetesën politike dhe ndër-etnike në Maqedoni. Të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin mendim se faktori shqiptar në Maqedoni është një faktor shumë i rëndësishëm stabiliteti dhe i orientuar qartë nga BE dhe NATO.

Spahiu: PS të fusë në rend dite, statusin e minatorit

Lëvizja Socialiste për Integritim kundërshtoi dje, nismën e qeverisë për të vendosur TVSH të biznesit i vogël. Deputeti Përpam Spahiu tha se TVSH duhet të përjashtohet nga biznesi i vogël, pasi ky ka qenë dhe një shqetësim i FMN. "Përjashtimi nga TVSH për bizneset e vogla, ky ka qenë dhe një shqetësim i FMN", tha Spahiu. Më tej, deputeti i bëri thirrje Kuvendit të fusë sa më shpejt në rend dite projektin për statusin e minatorit, duke e cilësuar këtë një shtresë të varfër dhe të pambrojtur të shoqërisë. "U diskutua statusi i minatorit. Prej më shumë se një muaji është bërë propozimi në komision, por akoma s'kemi një propozim të tillë. Grupi i LSI i bëri thirrje Kuvendit ta fusë sa më shpejt në rend dite statusin e minatorit", tha Spahiu.

Ministri i Brendshëm: Kemi informacione për njerëz të caktuar

Vetingu në polici, Xhafaj: Do të mbyllet brenda 2018, ende nuk ka shifra



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

për mos të qenë më pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit. Të jemi korrekt. Thjeshtë informacione për njerëz të caktuar. Normale, sepse unë jam ministër i Brendshëm dhe bën pjesë në funksionet e mia. Por të bësh një veting të të gjithë atyre,

kaq të gjerë me të gjitha këto kërkesa që ne kemi paraqitur është një tjetër gjë. Le t'ia lëmë kohës", deklaroi Xhafaj. Ministri u pyet nga gazetarja e News 24 se si është arritur në përfundimin që ka arritur DISK (Drejtoria e Sigurimit të Informacionit

të Klasifikuar) për të përjashtuar një sërë oficerësh policie të mos kenë akses në informacionet e klasifikuara. "Është një proces që e bën DISK-ja. Ne e marrim të mirëqenë atë që vjen nga DISK-ja. DISK-ja është një institucion që ka rregullat e veta, veprim mbi bazën e informacioneve që grumbullon, jo thjeshtë vetëm nga Policia e Shtetit sigurisht, por nga një sërë agjencish të tjera dhe mbi bazën e atyre agjencive nxjerr konkluzione. Pastaj ky nuk është një detyrim për ta pezulluar, për ta larguar të paktën për momentin nëse, nuk e di se çfarë se si do të rezultojë kjo me faktorë të tjerë në kuadrin e vetingut, por natyrisht nuk mund të rrinë në ato vende pune që disponojnë, ose që operojnë me dokumente të klasifikuara", shpjegoi Xhafaj.

Zbardhen përgjimet e biznesmenit 25-vjeçar me të atin, shoferin dhe kompaninë "Kurum"

Krimet e Rënda lënë në burg Orest Sotën

Prokuroria: Dyshime se paratë e gjetura në makinë janë të Tahirit

Ina Allkanjari

Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për biznesmenin Orest Sota, i cili u arrestua pak kohë më parë pasi në makinë iu gjetën 863 mijë euro dhe dy patentat e lundrimit të ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Biznesmeni 25-vjeçari akuzohet për veprat penale "Pastrim i parave", "Kundërshtim i forcave të policisë" dhe "Drejtim mjete në mënyrë të parregullt". Gjatë seancës gjyqësore prokurorët ngritën dyshime se paratë që u gjetën në makinën e Orest Sotës, i përkasin ish-ministrit të Brendshëm dhe janë produkt i veprimtarisë kriminale. Kjo është arsyeja përse organi i akuzës vendosi t'i bashkojë në një të vetme dosjen "Sota" me të "Tahirit" dhe "Habilajve". Po përkundrazi dyshimit të prokurorisë, Orest Sota këmbëngul se shuma prej 863 mijë euro është e babait të tij dhe çdo qindarkë është e ligjshme, produkt i biznesit të pastër të familjes. Avokatët e Orest Sotës i thanë Gjykatës se posedojnë dokumente që vërtetojnë bashkëpunimin financiar mes kompanisë "Kurum" dhe shoqërisë "Ikona". Gjithashtu, mes materialeve të vëna në dispozicion të gjykatës ishin edhe disa përgjime ambientale të të akuzuarit me shoferin e tij si dhe një komunikim që biznesmeni Lefter Sota ka pasur me drejtuesit e kompanisë "Kurum". Sakaq pritet që mbrojtja të apelojë vendimin në Gjykatën e Shkallës së Dytë.

PËRGJIMET

Në seancën gjyqësore të mbajtur dje pranë krimeve të rënda, ndaj biznesmenit Orest Sota u paraqitën prova të tjera për rastin, si dhe biseda të përgjuara. Mes provave të vëna në dispozicion të gjykatës ishte edhe biseda që Orest Sota ka zhvilluar me babain e tij në momentin që është ndaluar nga policia. Në një bisedë të zhvilluar në "What's up", biznesmeni Lefter Sota i kërkon të birit të shkojë te Metalurgjiku, por vetëm disa minuta më pas 25-vjeçari e njofton se është ndaluar nga policia. Sa i përket dy patentave të lundrimit të Saimir Tahirit, biznesmeni dëgjohej në përgjime teksa shpreh habi, për faktin që ato ndodheshin në automjetin me të cilin udhëtonte natën e arrestimit. Në përgjimet ambientale




Biznesmeni Orest Sota

DYSHIMET

Prokurorët ngritën dyshime se paratë që u gjetën në makinën e Orest Sotës, i përkasin ish-ministrit të Brendshëm dhe janë produkt i veprimtarisë kriminale.

në policinë e Elbasanit, Sota pyet shoferin e tij Leonard Almet, "Pse i ka lënë ato në makinë". Almet i përgjigjet, "Kot ore kot. I ka lënë Gentini". Bëhet fjalë për Gentian Cakën, shoferin e ish-ministrit të Brendshëm, i cili në përgjime dëgjohej t'i thotë Almetës, "Patentat i kam

harruar unë. Oresti s'di gjë". Sakaq nga përgjimet zbardhet edhe një bisedë e zhvilluar mes Lefter Sotës me përfaqësuesit e shoqërisë turke. Në datë 21 shtator, biznesmeni Lefter Sota i shkruan Korai Kurum, ndërsa në datë 24 tetor ky i fundit i dërgon numrin e telefonit të



Faksimile epërgjimeve të Sotës

AVOKATI I BIZNESMENIT SOTA

Në përfundim të seancës gjyqësore, Fatmir Brakaj, avokati mbrojtës i biznesmenit Orest Sota, thotë se paratë e gjetura në makinën e klientit të tij janë të justifikuar, pasi përdoren për aktivitetin e biznesit të familjes. Për sa i përket akuzave të prokurorisë që lidh shumën e parave me Saimir Tahirin, avokati i Sotës shprehet se nuk mbështetet në prova. Brakaj tha se disponon të gjitha provat se 863 mijë eurot janë të Lefter Sotës, ndërsa do të

paguheshin te KURUM për një sasi hekuri. Avokati deklaroi se ka prova të bisedës së Lefter Sotës me aksionerët e KURUM për pagesën që do të kryej, çka hedh poshtë sipas tij dëshminë e financiarit. Gjithashtu, Brakaj thotë se klienti i tij nuk kishte dijeni për faktin se patentat e Saimir Tahirit ndodheshin në makinat e tij dhe kjo sipas tij kjo gjë vërtetohet nga përgjimet ambientale. "Shuma është e justifikuar, pasi janë tërhequr nga banka pas shitjes së disa aksioneve, janë tërhequr kesh, fitimet kanë qenë shumëfishi i kë-

tyre parave të gjetura. Paratë janë të Lefter Sotës. Për sa u përket patentave, më mirë shpjegimet i pa prokuroria. Nga përgjimet del e qartë që shoferi ka pranuar se ka bërë gabim se i ka harruar atje dhe Sota nuk kishte dijeni se ishin në makinë. Njohje ka me ish-ministrit, pasi ka edhe me shoferin, por kjo nuk ka lidhje. Paratë të Saimir Tahirit? Prokuroria e deklaroi këtë fakt, por nuk e mbështeti në asnjë provë. Prokuroria të bëjë hetime. Një ditë para arrestimit, i ati bëri bisedë për pagesën te Kurum. Njëri nga dy turqit më të cilët ka folur Lefter Sota është aksioner. Orest Sota kur është ndaluar, policia telefonin nuk e hapte dot se ka qenë me kod, më pas ka qenë i gatshëm ai që e ka hapur telefonin. Prokuroria nuk e sjell si provë, por të merren tabulatet, është lehtësisht e verifikueshme. Lefter Sota në komunikimin me të birin, del se po shkante atje, madje u kap brenda Kurumit. Lefter Sota nuk ka bërë asnjë bisedë me financiarin, por me dy turq të tjerë. Ka pasur një marrëveshje verbale mes biznesmenit dhe Kurum. Nga momenti që i është kapur i biri, Lefter Sota i ka paguar Kurum 700 mijë euro" -deklaroi avokati mbrojtës i Orest Sotës, Fatmir Brakaj.

Siguria rrugore, aksion në Tiranë, pezullohen 18 patenta

Operacioni "Forca e ligjit", Haki Çako: Luftë ndaj çdo veprimtarie kriminale

TIRANE. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Haki Çako si dhe Drejtori i ARRSH-së Afrim Qendro në kuadër të 'Javës së Sigurisë Rrugore', në prononcim për mediat ditën e djeshme kanë bërë të ditura masat e ndërmarra nga policia. Çako tha se operacioni 'Forca e ligjit' do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj në bashkëpunim me partnerët tanë. Që do të thotë luftë pa kompromis ndaj çdo veprimtarie kriminale dhe sidomos organizatave të strukturara kriminale. Policia e Shtetit do të vazhdojë të punojë ngushtësisht me të gjithë autoritet dhe faktorët e tjerë për të kapur standardet e BE në drejtimin e parandalimit të aksidenteve me pasoja në mënyrë të veçantë ashtu sikurse po punon për kontrollin e lëvizjeve, por



Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Haki Çako

edhe monitorimin me të gjithë hapësirën e vendit tonë"- tha Çako. Ndërkohë Policia Rrugore e Tiranës ka vijuar punën për rritjen e parametrave të sigurisë rrugore. Kontrolltet janë përqendruar jo vetëm për alkoolin apo për shpejtësi të normave të lejuara, por një kontroll i imtësishëm po

ushrohet për evidentimin dhe ndëshkimin e gjithë atyre që drejtojnë motoçikletat pa leje drejtimi apo pa kaskë mbrojtëse. Në këtë kuadër janë arrestuar në flagrancë 5 drejtues motoçikletash pa leje drejtimi; 4 drejtues mjeteve në gjendje të dehur dhe janë pezulluar 18 leje drejtimi.



Dosja "Habilaj", Ministria e Drejtësisë Gjonaj: Përfundon përkthimi

Ministria e Drejtësisë ka përfunduar përkthimin e të gjithë dosjes "Habilaj" që kishte mbërritur nga autoritetet italiane. Sipas ministres Gjonaj, materiali 1800 faqe, do të dorëzohet gjatë ditës së hënë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. "Ne kemi kryer të gjitha procedurat sipas ligjit. Ka ardhur një dosje voluminoze, besoj sot do t'ia transmetojmë prokurorisë. Dosja na ka ardhur para gati dhjetë ditësh. Ka përfunduar përkthimi dhe do ta dorëzojmë sot", tha Gjonaj. Dosja e Prokurorisë së Katanias, ndaj grupit të trafikut të drogës që drejtohej pikërisht nga vëllezërit Moisi e Florian Habilaj, mbërriti në Shqipëri 10 ditë më parë në rrugë zyrtare. Në të janë të gjitha aktet dhe provat e prokurorisë së Katanias, të mbledhura në 4 vite hetime. E njëjta dosje do të paraqitet edhe nga prokuroria italiane në gjykatë. Në Shqipëri kjo dosje pritet të shërbejë për të vijuar hetimet në ngarkim të Habilajve dhe personave të tjerë të akuzuar si pjesëtarë të këtij grupi, të akuzuar për trafik ndërkombëtar droge. Në këtë dosje aludohet se është i përfshirë edhe ish - ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri.

Rritet taksa e pronës për banesat 0.05%, për bizneset 0.2% të vlerës së tregut

Ornela Manjani

Komisioni i Ekonomisë ka miratuar dje nën për nen paketën fiskale për vitin e ardhshëm, ku është parashikuar vendosja e takës së banesës sipas vlerës së objektit, pavarësisht zonës ku është ndërtuar. Nga kjo tarifë do të përjashtohen 90 mijë familje ku përfshihen kryefamiljarët pensionistë, personat me ndihmë ekonomike, invalidët dhe personat me aftësi të kufizuar. Çmimet e ndërtesave përcaktohen nga tregu i lirë dhe e njëjtë duket se do të jetë edhe logjika e taksimit të tyre. Ministri i Financave dhe Ekonomisë Arben Ahmetaj tha në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave se puna e kadasërës fiskale do të jetë përcaktimi i një takse sa më të drejtë në raport me zonën ku është banesa. Mbi vlerën që ka kjo e fundit do të merret një përqindje 0.05, të paktën për individët. Vendosjes së një çmimi sa më real i ka paraprirë pjesa e rivlerësimit të pasurive që u mbyll në maj të këtij viti. Gjithsesi për çdo rast që nuk ka kaluar këtë proces, kadasra do të ketë vlerësimin e saj që sjell pasurinë në vlerën e tregut. Në çdo rast mes çmimit minimal dhe çmimit maksimal të një zone të caktuar duket se vlerësimi do të bëhet mbi maksimalin. Sipas ministrit, nëse individit blen në një zonë ku çmimi minimum fiskal është 1000 euro/m², dhe transakcionet janë 1300/m² euro do të paguaj mbi vlerën e tregut 1300 euro/m². Diskutimet kanë rezultuar edhe me një rritje të takses që do të paguaj biznesi. Ministria e Financave kishte propozuar që fillimisht përqindja që do të aplikohet mbi çmimin e një ndërtese që përdoret për veprimtari ekonomike të ishte 0.15%, por që më pas propozimi erdhi për 0.2%. Këtë e ka miratuar edhe Komisioni duke bërë që biznesi tashmë të taksohet me vlerën më të lartë sesa draftri i fillimit. Deputetja e Partisë Demokratike Jorida Tabaku kërkoi që Financat të jenë më të qartë lidhur me metodologjinë që do të aplikojnë për taksën e pronës, e cila në vitin 2018 hyn në një cikël komplet të ri.

PASTRIMI I PARAVE

Kryetari i Komisionit Erion Braçe pohoi deformimin e çmimeve që mund të sjellin në treg paratë e pista. Sipas tij mund të ketë raste kur individët të caktuar mund të blejnë me një çmim më të lartë sesa çmimi mesatar i tregut, thjesht me synimin e pastrimit të parave dhe kjo mund të rezultojë në një çmim më të lartë, që automatikisht rrit taksën mbi ndërtesën. Po kështu ai nënvizoi faktin që taksa e pronës, e cila do të paguhet çdo tre muaj në faturën e

Taksa mbi shtëpitë, përjashtohen 90 mijë familje, ja kush përfiton

Braçe: Pastrimi i parave mund të deformojnë çmimin e pronës



Kërkesat e Dhomës Amerikane e Tregtisë

Përfaqësues të Dhomës Amerikane kanë kërkuar që të ketë qëndrueshmëri të legjislacionit fiskal, ndërkohë që i rikujtuan mazhorancës që të mbajnë premtimet e dhëna para zgjedhjeve, për uljen e nivelit të dividendit dhe tatimit mbi të ardhurat personale. "Të mbani premtimin elektoral, premtuar shumë pastër dhe qartë në të shkruar. Ata kërkuar që të mbani premtimin për 18 për qind, taksën maksimale të tatimit mbi pagën dhe 6 për qind të tatimit mbi dividendin. Është një lutje, këto janë komente tepër konstruktive, por, gjithsecili pret që premtimi të mbahet." - u shpreh Gent Daci, zv.president i Dhomës Amerikane të Tregtisë. Por presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Mark Crowford është shprehur se, nëse kërkesat e tyre nuk merren parasysh, ata përsëri do ia paraqesin qeverisë vitin e ardhshëm. Ndërsa kreu i biznesit kryeqytetas, Jaka, gjatë diskutimit për taksën e pronës, kërkoi që të ndërhyhet në ligjin për urbanistikën.



energjisë elektrike mund të japë ndikim tek arkëtimet e OSHEE pasi vlera e faturës do të rezultojnë dukshëm më e lartë se mesatarja që paguan një familje. Sipas tij mund të ketë raste kur individët të caktuar mund të blejnë me një çmim më të lartë sesa çmimi mesatar i tregut, thjesht me synimin e pastrimit të parave dhe kjo mund të rezultojë në një çmim më të lartë, që automatikisht rrit taksën mbi ndërtesën. Po kështu ai nënvizoi faktin që taksa e pronës, e cila do të paguhet çdo tre muaj në faturën e

kështu ai nënvizoi faktin që taksa e pronës, e cila do të paguhet çdo tre muaj në faturën e energjisë elektrike mund të japë ndikim tek arkëtimet e OSHEE, pasi vlera e faturës do të rezultojnë dukshëm më e lartë se mesatarja që paguan një familje. "Mund të ketë lajthitje, sepse dikush në pallatin tim, për të pastruar para, do që ta rrisë çmimin nga 1 mijë në 1800 dhe ky është transakcion tregu." - tha Braçe.

DEBATI PËR TVSH-NË

ERION BRAÇE: Brenda resorteve apo këtyre hoteleve me 5 vje mund të krijohen, si i quanim që moti në '97, magazina doganore që mund të kthehen lehtësisht në qendra kontrabande. Unë jam në vete, zoti ministër, por mos më thoni që kjo gjë nuk ka ndodhur.

ARBEN AHMETAJ: Po si mund të krijohet brenda hotelit me 5 vje magazinë doganore?

ERION BRAÇE: "Zoti ministër, jo qendër doganore, por qendër kontrabande e themi kështu, d.m.th. blen 13 mijë shishe uiski dhe i shet brenda një muaji me 6 për qind TVSH".

ARBEN AHMETAJ: Ato që blen ai i konsumon në operacionet e veta brenda strukturës akomoduese. Pra, e thënë ndryshe ato 10 shishe uiski apo 10 shishe verë ato pihen aty në restorant ose në bar, nuk mbahen aty kontrabandë për t'u shitur për jashtë.

Propozimet e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë

Jaka: Të përjashtohen nga TVSH-ja profesionet e lira

Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Nikolin Jaka ka kërkuar përjashtim nga TVSH-ja të profesioneve të lira. Nikolin Jaka tha në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave se "Ulja e pragut të TVSH 2 mln do të rrisë informalitetin". Ai kërkoi, gjithashtu, se tatimi për pagat deri në 35 mijë lekë të jetë zero. Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, tha se taksa për shtëpinë e parë të jete zero dhe të paguajnë ata që kanë më shumë se një banesë. Deklaratat e Nikolin Jakës u bënë në Komisionin e Ekonomisë, ku diskutohet paketa fiskale me grupet e interesit. Komuniteti i biznesit ka paraqitur kërkesat e tij për paketën fiskale që do të shoqërojë buxhetin e vitit të ardhshëm, e cila u diskutua nën për nen në Komisionin parlamentar të Ekonomisë. Përfaqësues të Dhomës së Tregtisë së Tiranës dhe asaj Amerikane kanë paraqitur kërkesat e tyre pranë këtij komi-



sion. Kërkesat kryesisht janë fokusuar tek ndryshimi i pragut të TVSH për biznesin e vogël, si dhe tek taksa mbi pronën. Sipas kreut të Dhomës së Tiranës, Nikolin Jaka, biznesi i vogël është "masha" që përdor biznesi i madh për të bërë evazion. "Duhet të heqim pragun për qarkullimin tregtar. Pra, duhet të heqim pragun për ato sipërmarrje të vogla, të cilat akoma vazhdojnë të mishërohen dhe jo të suportohen që të jenë eficientë në ekonomi. Ne mendojmë që për xhiron deri në



Çmimet e pasurive të paluajtshme

Në fund të vitit të kaluar u konstatua në tregun e pasurive të paluajtshme një rritje e çmimeve të apartamenteve në kryeqytet me rreth 10% që, sipas aktorëve të tregut erdhi pasi u konstatua një rritje e kërkesës dhe blerje e apartamenteve me para në dorë. Më pas çmimet ranë sërish për shkak të shtimit të ofertës, teksa shumë palatë të reja nisën të ngriheshin nëpër Tiranë. Aktualisht tregu është stabilizuar dhe në zonën e Unazës çmimet variojnë mes 1000-2500 euro për metër katror, ndërsa në periferi kanë shënuar një rritje me 10-15% së fundmi, dhe luhaten midis 500-650 euro për metër katror.

5 mln lekë tatim fitimi të jetë zero. Nga 5 mln deri në 14 mln të jetë 5 për qind dhe për xhiro më të lartë se 14 mln të jetë 10 për qind, pra të mos ketë lidhje tatim fitimi me TVSH. Pra, në goftë se për TVSH kemi pragje apo përjashtime për tatim fitimin, duhet të ketë qarkullim tregtar në mënyrë që të përfitojmë ato të mundësojmë sërish atë që në tashmë e kemi si objektiv si dhomë tregtie, krijimi i shtresës së mesme"- u shpreh Jaka.

ISHTI, masat administrative variojnë nga 1 mijë deri në 100 mijë lekë

Shkelën kushtet e sigurisë, gjobiten 14 subjekte që tregtojnë gaz

Intensifikohen kontrollet në të gjithë vendin për sigurinë

Ornela Manjani

Shkelja e kushteve të sigurisë për mbushjen e bombolave të gazit për konsumatorët familjarë, mosrespektim i rregullores me pasojë aksidente të rënda dhe mungesa e dokumentacionit kanë çuar në gjobitjen e 14 subjekteve që tregtojnë gaz në të gjithë vendin. Masat administrative janë marrë gjatë muajit tetor nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial. Referuar listës të bërë publike nga ky inspektorat, pjesa më e madhe e të penalizuara janë biznese që nuk kanë respektuar standardet që lidhen me sigurinë mbi gazin. Konkretisht, bizneseve u ka munguar projekti teknologjik për rezervuarin e GLN (gazit të lëngshëm). Por këto nuk janë rastet e vetme, në disa të tjera bizneset nuk disponojnë dokumentacion për ushtrimin e aktivitetit, rregulloret janë anashkaluar duke përbërë kërcënim për jetën e qytetarëve apo janë bërë mbushje bombolash për familjarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore. Në total vlera e masave administrative është mbi 3.3 milionë lekë.



KONTROLLET

Kontrollet e muajit të dhjetë të vitit kanë përfshirë gjithë vendin, por janë përqendruar kryesisht në zonën e Korçës. Gjithsesi, në raport me muajt e verës duket se numri i penalizimeve ka ardhur në rënie. Në shtator ishin në total ishën 16 gjoja me një vlerë prej 3.3 milionë lekë. Këto janë duk-

shëm masa më të pakta krahasuar me gushtin, i cili regjistroi të paktën 62 masa me një vlerë prej 16.9 milionë lekë. Rritja e vëmendjes gjatë muajve të verës ishte kryesisht e fokusuar tek bregdeti dhe nga karburantet u zhvendos më shumë tek bizneset hoteliere dhe bar-restorant, për shkak edhe të një ngjarjeje me pa-

soja fatale të ndodhur në Velipojë. Gjithsesi, tregu i karburanteve dhe tregtimin të gazit ka qenë në zhvillim dinamikë gjatë këtij viti, lidhur edhe me zbatimin e kuadrit ligjor që vendosi vëmendje sidomos tek mënyra e tregimit të gazit dhe standardet që duhet të respektohen nga kompanitë.

TABELA E SANKSIONEVE TË ISHTI-T PËR INSPEKTIMET E PERIUOHËS TETOR 2017

NR	DATA E KONTROLLIT	EMRI I SUBJEKTTË	VENDODHJA FIZIKE E OBIJEKTTË	TREQUESIT E KONSTATUARA / NATYRA E SHKELJES	MASAT ADMINISTRATIVE	REFERENCA LIGJORE	SHËNIME
1	04.10.2017	FLUMË GAS	Rruga Kavajë, Zonë Kadastrore nr. 3321, në pasurinë SHK Shkurt, Tiranë	Mungesa Dokumentacioni	500,000	Ligji 8450-ib-24.03.2016 nr.1999 ndryshuar-MEM 15, FKA 1, paragrafi 1-trënd dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "njëligj"	
2	11.10.2017	ALDI SHK	Himara	Rezervuar GEN- të cilët nuk plotësojnë kërkesat e rregullores të sigurisë	500,000	Ligji nr. 32/2016-ib-24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punks së Fajgëve dhe Instalimeve nën Presion" (neni 4,pika 1 dhe neni 25, pika 1 gërma "a")	
3	06.10.2017	INDERTUES BOKI	Almarrat, Prezë	Mungesa Dokumentacioni	100,000	Ligji 8450-ib-24.03.2016 nr.1999 ndryshuar-MEM 15, FKA 1, paragrafi 1-trënd dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "njëligj"	
4	12.10.2017	LAURENT	Kishin, Murrumbishe	Mungesa Dokumentacioni	100,000	Ligji 8450-ib-24.03.2016 nr.1999 ndryshuar-MEM 15, FKA 1, paragrafi 1-trënd dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "njëligj"	
5	30.10.2017	KRALING SA	Sheqer Vëgël, pranë degës së Fier	Mbushje bombolash për përdorim familjar në kundërshtim me ligjin	500,000	Ligji 8450-ib-24.03.2016 nr.1999 ndryshuar-MEM 15, FKA 1 dhe 4 dhe bazuar në nenin 25, pika 1, gërma "c"	
6	03.10.2017	EGNATA GAZ 2015	Rugovë, Korçë	Nuk ka përfunduar procesin e miratimit të Projektit Teknologjik nga punët e reja	0	Udhëzimet, detyrimet dhe kushtet e Dokumentacionit Teknologjik	Ligji nr. 32/2016-ib-24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punks së Fajgëve dhe Instalimeve nën Presion"
7	03.10.2018	VASHTRIA	Rr. Vashtrisë - Librazhd, Korçë	Mungesa e dokumentacionit teknik të nevojshëm për rezervuarin e GLN	300,000	Ligji nr. 32/2016-ib-24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punks së Fajgëve dhe Instalimeve nën Presion" neni 5,pika 2 dhe 3 dhe neni 25, pika 1 gërma "c"	
8	03.10.2018	NORA ASALAT	Rr. Resonance-Skopje, Korçë	Mungesa të Projektit Teknologjik të rezervuarit të GLN	500,000	Ligji nr. 32/2016-ib-24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punks së Fajgëve dhe Instalimeve nën Presion" neni 4,pika 1 dhe neni 25, pika 1 gërma "a")	
9	03.10.2018	SHAKA BODROSHITJE	Belishtin, Korçë	Mungesa e dokumentacionit teknik të nevojshëm për kalidimin e gazit	300,000	Ligji nr. 32/2016-ib-24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punks së Fajgëve dhe Instalimeve nën Presion" neni 5,pika 2 dhe 3 dhe neni 25, pika 1 gërma "c"	
10	04.10.2017	EV PRO	Lagja Nr. 1, Korçë	Mungesa e dokumentacionit teknik të nevojshëm për rezervuarin e GLN	300,000	Ligji nr. 32/2016-ib-24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punks së Fajgëve dhe Instalimeve nën Presion" neni 5,pika 2 dhe 3 dhe neni 25, pika 1 gërma "c"	
11	04.10.2017	PRO - FAST	Rruga Shkollës - Drenovë, Korçë	Mungesa të Projektit Teknologjik të rezervuarit të GLN	300,000	Ligji nr. 32/2016-ib-24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punks së Fajgëve dhe Instalimeve nën Presion" neni 4,pika 1 dhe neni 25, pika 1 gërma "a")	
12	06.10.2017	Bedri Çetaniqev Person Fik	Lagja 14, Rr. Kripa Derrit, Durres	Mos rregullimi i pajisjeve nën presion, rezervuar GLN	50,000	Ligji nr. 32/2016-ib-24.03.2016 "Për garantimin e Sigurisë së Punks së Fajgëve dhe Instalimeve nën Presion" neni 5,pika 1 gërma "a")	
13	09.10.2015	Urina Shpa SHK	Kulla nr. 3, Kompleksi Green Park, Rruga "Strandorë Bregdeti", Rruga Rruga Kështjariq nr. 5, Tiranë	Mos Respektim të Rregullores për pajisjet e vendit të vendit	10,000	Ligji 8738 "Për garantimin e Sigurisë së Punks të pajisjeve dhe instalimeve nën presion", ndryshuar ib-02.03.2015, neni 5, pika 1, gërma "a"	
14	20.10.2017	Khujaga SH SHK	Cudhëri që kundërshtojnë rregulloren, Fshati Turke Fshatit, Berat	Mos Respektim të Rregullores për pajisjet e vendit të vendit	10,000	Rregulloren e Sigurisë dhe Shkëmbimit Teknik për Instalimet, Fajgjet dhe Instalimet FKA 5-35 dhe ligji 8738 "Për garantimin e Sigurisë së Punks të pajisjeve dhe instalimeve nën presion", ndryshuar ib-02.03.2015, neni 5, pika 1, gërma "a")	
					VËLERA TOTALE E GJOBAVE	3,070,000 Lekë	

"Wizz Air" njofton hapjen e linjës 'low-cost'

Tiranë - Londër, fluturime 4 herë në javë

Linja e fluturimeve ajrore me buxhet të ulët, "Wizz Air", njoftoi të hënën se do të zgjerojë operacionet në bazën në aeroportin Luton në Londër. Kompania tha se do t'i shtojë katër aeroplanë të rinj flotës deri në qershor 2018, duke hapur kështu edhe 5 destinacione të reja. "Airbus 320"-tat shtesë do të krijojnë rreth 150 vende pune në "Luton" - u shpreh linja ajrore, teksa flota e saj atje do të arrijë në 5 avionë. Ky zgjerim do ta lejojë linjën që operon kryesisht në Europën Lindore të nisë destinacione të reja për në Qipro, Silovaki, Estoni, Ukrainë dhe Shqipëri. Gjithashtu, avionët do të përdoren për të rritur edhe frekuencën e udhëtimeve në destinacionet popullore si Izrael, Rumania dhe Kosovë. Fluturimet nga Tirana për në Londër tashmë janë shfaqur në portalin zyrtar të "Wizz Air", të cilat mësohet se do të kenë një frekuencë prej 4 fluturimesh në javë dhe do të nisnin nga data 31 maj 2018. Çmimet sigurisht do të jenë 'low-cost' dhe duke u bazuar në ato nga Prishtina drejt Londrës pritet të nisnin nga 30 euro vetëm vajtje. Deri më tani, ky operator kishte vetëm një destinacion në Shqipëri, atë drejt Budapestit. Zgjerimi i kompanisë vjen në një kohë kur të ardhurat e kompanisë janë në nivele të larta. Për gjysmën e parë të vitit operatori shënoi 288 milionë euro fitime, 24.6% më shumë se një vit më parë. Edhe numri i pasagjerëve për këtë vit është rritur me %, duke shkuar në 15.6 milionë individë.



Ligji për faljen e detyrimeve të prapambetura

Edhe një shans i fundit për të përfituar, paguani detyrimet deri në 31 dhjetor



gjitha detyrimeve të tjera për gjoja dhe interesa të paguara. Tatimet kujtojnë se tatimpaguesit mund të konsultohen me legjislacionin tatimor lidhur me detyrimet që përjashtohen nga falja në udhëzimin e

Ministrit së Financave, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në rubrikën e 'Legjislacionin tatimor' lidhur me detyrimet që përjashtohen nga falja në udhëzimin e

Administrata Tatimore u bën thirrje të gjithë tatimpaguesve, të cilët kanë detyrime principali të paguara për periudhën 2011-2014, të kryejnë sa më parë pagesën e këtij principi për të përfituar fshirjen/shuarjen e të gjitha detyrimeve të tjera për gjoja dhe interesa të paguara.

tike të detyrimeve për periudhën përpara vitit 2010 dhe të 2011-2014, gjithashtu edhe fshirja e detyrimeve me kusht për periudhën 2011-2014 për ata tatimpagues që kanë paguar principalin.



Kushtet e shkollës Vëndreshë e III në Skrapar

Drejtori: Nuk tërhiqemi nga misioni ynë, do e rindërtojmë shkollën sërish

Skrapar, vogëlushët mësojnë në "qiell të hapur"

Donald Dervishi: Godina ekzistuese është rrënuar

Voltiza Duro

Rethuar nga mure plot lagështi, një tavan me trarë që mund të rrëzohet nga çasti në çast, kjo dhomë "ahur" është "klasa" ku fëmijët e fshatit Vëndreshë të Skraparit marrin dije. Pikturat e vogëlushëve mbulojnë sadopak plasaritjen e godinës, ndërsa një fletë e madhe shërben si dërrasë e zezë ku ata mësojnë gjuhën shqipe. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Donald Dervishi, drejtor i shkollës Vëndreshë e III në Skrapar tregon se kushtet ku nxënësit arsimohen janë mizerabël, por pavarësisht kësaj, shprehet i vendosur se, së bashku me mësuesin, nuk do të tërhiqen nga misioni fisnik dhe do ta ndërtojnë në çdo mënyrë godinën nga e para.

Si paraqiten kushtet e shkollës Vëndreshë e III në Skrapar?

Shkolla Vëndreshë e III e fshatit me të njëjtën emër është ndërtuar që në kohën e komunizmit dhe është një nga pesë shkollat që ka në administrim drejtorja e shkollës "Ferit Bregu" Vëndreshë, ku drejtor jam unë. Gjendja e kësaj shkolle është eqivalentuar dhe vënë në dukje nga ana ime, pasi u bëra drejtor i saj në 16 qershor të 2017-ës. Mund të them që kushtet e shkollës janë mizerabël, nuk mund të jepet mësim në një gjendje të tillë, por misioni fisnik që kemi mbi supe, na bën që të përballemi edhe me situata të tilla. Godina ekzistuese është tashmë e rrënuar.

Ku zhvillohet mësimi tani?

Godina ku ne zhvillojmë mësim aktualisht është një ndërtesë private e marrë me qira për nevojat e shkollës, pasi godina ekzistente u rrënuar. Por ne nuk mund t'i lëmë fëmijët pa mësim, është detyra jonë që të gjejmë çdo mënyrë për t'i arsimuar.

Kush e paguan qiranën e



Donald Dervishi, drejtor i shkollës Vëndreshë e III në Skrapar

kësaj godine?

Qiranë e kësaj godine që ka marrë funksionin e shkollës e paguan Bashkia Skrapar, por vlerën e saktë të pagesës nuk e di, por nuk besoj se është më shumë se 4 mijë lek të reja në muaj. Ka edhe shtëpi të tjera që mund të merren me qira, por nuk

ndryshojnë shumë nga kushtet.

Sa nxënës dhe sa mësues ka aktualisht kjo shkollë?

Në këtë shkollë mësojnë gjithsej 5 fëmijë, prej tyre njëri është në ciklin parashkollor dhe një tjetër në ciklin e lartë. Ndërsa 3 fëmijë janë nxënës të ciklit fillor.

Ndërsa është vetëm një mësues që jep mësim prej 6 vitesh në këtë shkollë, i cili quhet Borsion Spaho i specializuar për mësuesi në Ciklin e Ulët. Borsioni çdo ditë përshkruan plot 3 orë në ditë për të ardhur në fshat e për të përcjellë dije të këta fëmijë, edhe pse duhet që ta bëjë

punën e tij në kushte tejet çdo standardi.

Sa kilometra larg është shkolla më e afërt me fshatin Vëndreshë e III?

Shkolla më e afërt është 1 orë e 20 minuta larg fshatit çka e bën të pamundur që nxënësit të shkojnë çdo ditë në këmbë në shi apo dëborë, sepse rruga që të çon në këtë fshat është malore dhe shumë e lodhshme, sidomos për fëmijët.

Cila është thirrja juaj ndaj instancave përkatëse?

Unë nuk kam asnjë thirrje ndaj instancave përkatëse, sepse për kaq vite me radhe nuk është bërë asnjë gjë. Ne kërkojmë bashkëpunim, sensibilizim, mbështetje për të finalizuar me sukses misionin për të ndërtuar një shkollë të re, që tashmë ka marrë dritë jeshile. Ju lutemi të gjithë atyre njerëzve që kanë mundësi për të na ndihmuar me çdo lloj ndihme, materiale ndërtimi, materiale didaktike, donacione! Ftojme këdo që ndjehet i gatshëm, të na bashkohet në kauzën tonë!

Veliaj: Ftoj ambasadat e tjera për investime

Përurohet kopshti nr.60 në kryeqytet

Ka përfunduar rikonstruksioni i plotë kopshtit nr.60 në kryeqytet, i cili tashmë do të ofrojë për 75 vogëlushë ambiente krejtësisht moderne. Në përfundim të këtij kopshti ishte i pranishëm edhe kryebashkiaku, Erjon Veliaj i shoqëruar nga ambasadori i Turqisë në Tiranë, Hidayet Bayraktar dhe kryetari i Qarkut, Aldrin Dalipi. "Dua të ftoj prindërit që janë të interesuar, të vrapojnë të regjis-

trojnë fëmijët dhe nga 1 janari do të kemi mundësinë që të ofrojmë edhe shtretërit që janë gati, edhe kuzhinën që është gati. Kopshti do të jetë një kopsht me drekë", theksoi Veliaj. Duke falënderuar ambasadën turke për kontributin e dhënë, Veliaj ftoi edhe ambasadat e tjera që t'i bashkohen nismave të bashkisë për rikonstruktimin e institucioneve arsimore.



Rama dhe Nikolla me fëmijët në Kurbin, rikonstruksioni i plotë i shkollave të zonës

Në ditën ndërko mbëtare të fëmijëve, kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga ministrja e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla, zgjodhi të vizitonte fëmijët e shkollave të Kurbin. Në institucionet arsimore kryesore në këtë zonë ka përfunduar rikonstruksioni i plotë i godinave, çka ofron për fëmijët kushte optimale për të mësuar. Rama, në fjalën e tij, u shpreh se investimet në infrastrukturën arsimore dhe shëndetësore do të shtrihen në të gjithë vendin. "Në buxhetin e vitit tjetër kemi një tjetër paketë të rëndësishme, me 300 qendra shëndetësore në të gjithë Shqipërinë me standarde europiane dhe me po kaq shkolla të rindërtuara kompletojmë më në fund të gjithë nevojën e trashëguar prej çerekshekulli që faktikisht na mbeti në dorë me gjithë këto gërmadha nga të katër anët e Shqipërisë për shkak të mungesës së prioritizimit dhe të vëmendjes së fokusuar hap pas hapi, -tha kryeministri. Ndërsa, ministrja Nikolla theksoi se këto investime ishin të rëndësishme në Kurbin. "Është një investim prej 100 milionë lekësh të reja. Besoj përfundimi i investimit do ta kthejë realitet edhe në një shkollë Qendër Komunitare, sepse janë të gjitha parametrat në projekt që të mundësohet me shumë aktivitet edhe për komunitetin", - tha Nikolla.

Ndryshimet në buxhet: Do të rimburohen analizat gjenetike

Ja sa do të rritet ndihma ekonomike për personat me aftësi të kufizuara

Ndihma ekonomike për personat me aftësi të kufizuara do të bëhet 5600 lekë nga 3500 që ishte më parë si dhe do të ngrihen qendra rehabilitimi për këtë kategori. Gjithashtu, për fëmijët me sindromën Down do të bëhet rimbursimi i analizave gjenetike. Ky lajm është bërë me dije nga zv/ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bardhylka Kospiri.

SQARIMI

"Ndihma ekonomike përmirësohet dhe nuk do të ketë më ndihmë ekonomike të pjesshme, pra do të jetë ndihmë e plotë. Kjo duhet qartësuar, nuk është shprehur qartë. Shkon nga 3500 në 5600 lekë", - tha zv/ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bardhylka Kospiri

ekonomike të pjesshme, pra do të jetë ndihmë e plotë. Kjo duhet qartësuar, nuk është shprehur qartë. Shkon nga 3500 në 5600 lekë", -tha Kospiri. Këto vendime të cilat do të reflektohen në

buxhetin e vitit 2018, janë shqyrtuar nga MShMS, pas disa sugjerimeve që janë hedhur nga grupet e interesit. Por gjatë këtij takimi nuk kanë munguar as debatet mes maxhorancës dhe

opozitës, pasi grupet e interesit kanë propozuar edhe rritjen e pagës minimale me 30%. "Sa është në gjendja Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financës për të plotësuar nga këto halle që ne na janë parashtruar për dy ditë rresht? Ky është qëllimi kryesor që këto dëshira tonat që absolutisht jemi dakord, të bëhen realitet. Në qoftë se Shoqata e të Verbërve ka një problem që disa i kompensohet jeta e përditshme, i bëhet pak më njerëzore, ajo ka një fature



Komisioni i Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale

financiare. Pyetja është shumë e thjeshtë, i ka qeveria këto fonde?", - u shpreh Halim Kosova, deputet i PD-së. Ndërsa deputetja e PS-së, Klodiana Spahiu ka kërkuar një përgjigje konkrete nëse do miratohet shuma mbi rimbursimin e analizës gjenetike. Ndryshimet në buxhe-

tin e shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale do të kalojnë në Komisionin e Ekonomisë për të marrë aprovimin përfundimtar. Më tej, këto ndryshime në buxhetin e shëndetësisë do verifikohen nga Komisioni i Ekonomisë, i cili do të vendosë nëse do aprovohen apo jo.

APEL KUNDËR PUNËSIMIT, DHUNËS E DROGËS/ Të rinjtë: Presim përmirësim të situatës

Marshimi i "heshtur" i qindra fëmijëve në Kurbin

Vlahutin: Ligjet në letër nuk mjaftojnë

Voltiza Duro

Fëmijë e të rinj të Kurbin, zgjodhën të marshojnë në mënyrë të "heshtur", duke mbajtur në duar pankarta me mesazhe të forta sensibilizuese, për të gjitha të drejtat e mohuara. Në këtë protestë, të zhvilluar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, ishte e pranishme edhe ambasadorja e Bashkimit Europian, Romana Vlahutin, e cila tha se po bëhen ndryshime ligjore në bashkëpunim me qeverinë shqiptare. Por, sipas saj, ligjet e shkruara në letër nuk mjaftojnë për përmirësimin e situatës. "Ne e filluam vjet në Dibër këtë aktivitet, dhe po e vazhdojmë sivjet sërish këtu, pasi edhe zonat e tjera të Shqipërisë janë shumë të rëndësishme. Fakti që dikush nuk jeton në qytet të madh, nuk do të thotë që të mos gëzojë të njëjtat të drejta që i takojnë me ligj. Janë fëmijët ata që janë e ardhmja e vendit, prandaj duhet të investojmë në mënyrë që ata të përdorin çdo gjë që kanë, në mënyrë që e ardhmja të jetë më e mirë", -u shpreh Vlahutin teksa po marshonte përkrah fëmijëve. Pas kësaj, të rinjtë e Kurbinit organizuan një aktivitet ndërgjegjësues, në bashkëpunim me organizatën World Vision, e cila ka luajtur një rol të rëndësishëm në evidentimin e problematikave të tyre. Ata bënë thirrje kundër punësimit të fëmijëve, për shkak të kushteve të këqija ekonomike dhe kundër drogës në shkollë e formave



Marshimi i të rinjve në Kurbin

PROBLEMATIKA

Të rinjtë e Kurbinit organizuan një aktivitet ndërgjegjësues, në bashkëpunim me organizatën World Vision. Ata bënë thirrje kundër punësimit të fëmijëve, drogës në shkollë e formave të ndryshme të dhunës të hasura në familje apo komunitet.

të ndryshme të dhunës të hasura në familje apo komunitet.

PETICIONI

Ndërkohë, fëmijët bënë me dije se kanë dorëzuar një peticion drejt Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë; Ministrisë së Shën-

detësisë e Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë së Kurbinit në të cilin kanë listuar pikat më të rëndësishme që mbrojnë të drejtat e tyre. Së pari, ata kanë kërkuar ndërtimin e një qendre rinore në qytet ku mund të zhvillojnë aktivitetet për të kaluar kohën e lirë. Më tej kanë kërkuar rritjen e investimeve në institucionet arsimore, në mënyrë që ato të plotësojnë funksionin e tyre si qendra dijeje dhe komunitare për t'i përgatitur të rinjtë drejt profesioneve të së ardhmes. Madje, fëmijët në peticion kërkojnë që t'u sigurohet hapësira ku të mund të japin lirisht mendimin e tyre në lidhje me problematikat që shkelin të drejtat e tyre e t'u ofrohen shërbime të tilla që iu japin siguri e mbrojtje. Gjatë aktivitetit,

të rinjtë e fëmijët e Kurbinit shfaqën video-dokumentarë me histori personale e mesazhe të forta ndërgjegjësimi, ku personazhe ishin vetë ata. Ndër to, trajtohej edhe problemi i

AMBASADORJA E BE

"Edhe zonat e tjera të Shqipërisë janë shumë të rëndësishme. Fakti që dikush nuk jeton në qytet të madh, nuk do të thotë që të mos gëzojë të njëjtat të drejta që i takojnë me ligj. Janë fëmijët ata që janë e ardhmja e vendit, prandaj duhet të investojmë në mënyrë që ata të përdorin çdo gjë që kanë, në mënyrë që e ardhmja të jetë më e mirë", - u shpreh Vlahutin.

trafikimit të qenieve njerëzore, në të cilën një e re kishte rënë pre e prostitucionit. Edhe dhuna në shkollë apo bullizmi ishte një tjetër shqetësim i të rinjve të Kurbin. Ata kërkuar fu-

qishëm nga autoritetet përkatëse më shumë vëmendje dhe më shumë punë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, jo vetëm në qendrat urbane, por edhe në zonat e thella rurale.

Manastirliu: Shërbime sociale për 580 fëmijë në situatë rruge

Plot 580 fëmijë në situatë rruge kanë marrë shërbimet sociale që iu nevojiten, si dhe janë menaxhuar mbi 1400 raste të fëmijëve në rrezik abuzimi, dhune apo shfrytëzimi. Kjo deklaratë është bërë nga ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e cila bëri dije një vizitë në qendrën "Shkej" në periferi të Tiranës, ku trajtohen fëmijët në situatë rruge dhe ata me probleme social-ekonomike. Në

kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, Manastirliu theksoi se qeveria po angazhohet për të ofruar shërbime të integruara për fëmijët që ndodhen në kushte të këqija apo mund të bien pre e donjë forme abuzimi. "Këtë vit shikollor, ia dolëm të regjistrujmë në shkollë 208 fëmijë në situatë rruge, por kjo arritje do të ishte e paplotë nëse nuk arrimë të sigurojmë riintegrimin e plotë të familjes", -tha ministria.

13-vjeçarja: Më futi me forcë në makinë, më çoi në hotel

Abuzoi seksualisht me të miturën nga Kruja, përfundon në pranga 32-vjeçari nga Tirana

DURRËS - Një 32-vjeçar nga Tirana është arrestuar nga policia e Durrësit, pasi akuzohet se ka abuzuar seksualisht me një vajzë 13-vjeçare nga Kruja. Alfred Tereziu u kap pas denoncimit të bërë nga motra e të miturës. Kjo e fundit deklaroi para bluve se e motra ishte nisur për në shkollë dhe se pas mësimit nuk është kthyer në banesë. Menjëherë pas kallëzimit, policia nisi hetimet, ndërsa prangosi 32-vjeçarin.

Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Durrësit dje bënë me dije se 32-vjeçari u prangos, pasi dyshohet se ka abuzuar seksualisht me 13-vjeçaren me iniciale D.P. në një hotel.

Në dëshminë e dhënë në polici, e mitura ka thënë se është marrë me forcë nga iriu dhe se ishte përdhunuar. "Ky djali më ndaloi në autostradë, më mori në makinë dhe më çoi në një hotel ku më përdhunoi", është shprehur 13-vjeçarja nga Kruja. Pas denoncimit të saj, policia

e qytetit bregdetar ka shkuar në një hotel që ndodhet në autostradën Tiranë-Durrës dhe ka sekuestruar pamjet filmike. Përmes kamerave, e mitura ka arritur të dallojë të riun Alfred Tereziu. Blutë e Durrësit kanë bërë arrestimin e tij, por hetimet për ngjarjen vijojnë, pasi iriu ka një tjetër version për ngjarjen. Pritet që e mitura t'i nënshtrohet ekspertizës mjeko-ligjore nëse ka deflorim. "Vajzën e pashë në rrugë. Ajo ngriti dorën dhe unë e mora në



Foto ilustruese

makinë pasi po binte shi. E çova deri ku donte ajo. Nuk e kam prekur me dorë dhe aq më pak ta kem përdhunuar. Nuk e di se çfarë lidhte ajo, por unë nuk kam lidhje fare me këtë histori", ka pohuar 32-vjeçari.

Ndërkaq, materialet në ngarkim të tij i kanë kaluar për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale: "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur". **kl.ha.**

Policia fshehu ngjarjen. Dyshime për një grup të strukturuar banditësh

Horror në Durrës, maskat dhunojnë barbarisht bashkëshortët e moshuar

Agresorët i lidhën me skoç dhe i torturuan në karrige. Mjekët: 77-vjeçari Maliq Elezi pësoi hemorragji në tru

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Horror në fshatin Shkallnur të Durrësit. Dy të moshuar kanë përfunduar në spital, pasi janë dhunuar barbarisht në banesën e tyre nga tre persona të maskuar dhe të armatosur dhe më pas janë grabitur. Mësohet se bashkëshortët Elezi janë lidhur këmbë e duar me skoç në karrige dhe janë torturuar nga agresorët. Për minuta të tëra ata u janë lutur grabitësve që të mos i vrisnin. Si pasojë e dhunës, 77-vjeçari Maliq Elezi ka humbur vetëdijen në spitalin e qytetit bregdetar, ndaj më pas është dërguar në gjendje kritike për jetën në Spitalin e Traumës në Tiranë. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm, ndërsa është mbajtur e fshehur nga policia e Durrësit, e cila ka qenë në koherencë në raportimin e lajmeve të tjera të ditës, por jo për masakrimin e bashkëshortëve Elezi. Vetëm në orët e vona të mbrëmjes, blutë e qytetit bregdetar pohuan për "GSH" se dyshohet për një grup të strukturuar banditësh, të cilët pasi marrin informacion të detajuar për pleqtë e vetmuar dhe që kanë fëmijët në emigracion, i sulmojnë dhe i grabisin.

NGJARJA

Rreth orës 03:00, tre persona të armatosur kanë hyrë në banesën e familjes Elezi. 77-vjeçari Maliq Elezi dhe bashkëshortja e tij 69-vjeçare Sh. Elezi kanë qenë në gjumë, kur janë përballur me maskat. Këta të fundit i kanë ulur dy të moshuarit në karrige, i kanë lidhur me skoç këmbë e duar dhe në mes e më pas u kanë thënë që t'u tregojnë vendin ku mbanin paratë. Mësohet se kryefamiljari ka rezistuar duke u thënë se ishin pensionistë dhe se nuk kishin lekë në



77-vjeçari i plagosur, në spitalin e Durrësit

PROTESTA E FAMILJARËVE

Pas marrjes së lajmit se prindërit e tyre kishin përfunduar në spital nga dhuna e grabitësve, dy nga tre fëmijët e familjes Elezi kanë udhëtuar nga Italia e Greqia me avion dhe kanë mbërritur në Durrës. Ata janë tronditur tejet kur kanë parë babain të masakruar, ndërsa kanë akuzuar policinë. "Është e tmerrshme kjo që na ndodhi. Por, më e tmerrshme është fakti se policia nuk bën asgjë. As nuk na njoftoi për atë që ndodhi. Kjo është absurde", -u shprehën fëmijët e çiftit Elezi.

banesë. Kaq është dashur që agresorët të nisin torturat ndaj dy pleqve. Ata kanë goditur me grushte, shkelma e mjete të forta 77-vjeçarin duke i shkuar plagë të rënda në trup dhe në kokë. E terrorizuan nga dhuna që po ushtroj ndaj të shoqit, 69-vjeçarja iu është lutur grabitësve që ta linin të qetë. Por,

ata kanë filluar të godasin dhe atë me shpulla. "Ju lutem, mjaft. Ju tregoj vendin ku janë paratë që kemi në banesë. Ju lutem, mos ma vrisni burrin. Merrni çfarë të doni. Nuk i kemi as fëmijët këtu. Mos na vrisni! Do u them fëmijëve që të na nisin para vetëm na lini të qetë", -ka thënë mes lotësh e zonja e

shtëpisë. Më pas grabitësit u kanë zënë dhe gojën dy të moshuarve me skoç dhe kanë kthyer përmbys shtëpinë. Ata kanë marrë një shumë prej 1 milion lekësh të vjetër dhe janë larguar. Ndërkaq, 69-vjeçarja ka mundur të zgjidhë duart dhe ka njoftuar policinë e Durrësit, e cila ka shkuar shpejt në vendngjarje. Gjithashtu, në vendngjarje ka mbërritur dhe një ambulancë me një ekip mjekësh të spitalit të Durrësit. Dy të moshuarit janë dërguar në këtë spital rreth orës 05:00 të mëngjesit të djeshëm.

MJEKËT

Burime nga spitali i Durrësit deklaruan dje për "GSH" se 77-vjeçari është shtruar në pavionin e kirurgjisë. Sipas tyre ai kishte hematoma të dukshme në

TERRORI

E terrorizuar nga dhuna që po ushtrohej ndaj të shoqit, 69-vjeçarja iu është lutur grabitësve që ta linin të qetë. Por, ata kanë filluar të godasin dhe atë me shpulla. "Ju lutem mjaft. Ju tregoj vendin ku janë paratë që kemi në banesë. Ju lutem, mos ma vrisni burrin. Merrni çfarë të doni. Nuk i kemi as fëmijët këtu. Mos na vrisni! Do u them fëmijëve që të na nisin para vetëm na lini të qetë!", -ka thënë mes lotësh e zonja e shtëpisë.

trup si dhe rrjedhje gjaku në tru. "Kryefamiljari ishte dhunuar barbarisht dhe kishte hematoma në trup dhe në kokë. Ndërsa, e shoqja kishte pësuar tronditje të thellë psikologjike. Menjëherë dy të moshuarve iu është dhënë ndihma mjekësore", -tha mjeku i reparitit të urgjencës Arjan Tivari. Ndërkaq, burime nga ky spital pohuan se 69-vjeçarja Elezi ka njoftuar për ngjarjen tre fëmijët e saj që i ka në emigracion (dy vajza në Itali dhe djalin në Greqi). "Njëra nga vajzat erdhi me avion nga Italia. Po kështu dhe djali nga Greqia. Ata kërkuan që babai i tyre të dërgohej urgjentisht në Spitalin e Traumës në Tiranë. Kjo dhe për faktin se në mbrëmje 77-vjeçari humbi vetëdijen", -thanë burimet nga ky spital.

SHKURT

Asfiksioni i nxënësve, pezullohet 3 ditë mësimi

BULQIZË - Pas asfiksimit të 68 nxënësve e mësuesve pak ditë më parë në shkollën e mesme "Rifat Manjani" në Shupenz të Bulqizës nga tymi që çliroi vënia në punë e kaldajës, mësimi është pezulluar. Instituti i Shëndetit Publik ka kërkuar pezullimin e mësimi deri të mërkurën, pasi vijon testimi i kaldajave në shkollë. Testimi i sistemit të ngrohjes me pelet, për pak sa nuk ka shkaktoi tragjedi në shkollën e mesme. Gjatë provës, ka pasur rrjedhje gazi nga kaldaja e godinës, duke shkaktuar asfiksion të 66 nxënës dhe 2 mësues, të cilët u dërguan me urgjencë në spital.

Vjedhja e kasafortës, arrestohet roja i teatrit "Skampa"

ELBASAN - Një ditë pas ngjarjes së ndodhur në Elbasan, ku një sasi eurosh u vodhën në teatrin "Skampa", policia ka vënë në pranga rojën e objektit. 48-vjeçari Sokrat Thano akuzohet për neglizhencë në kryerjen e detyrës. Persona të paidentifikuar kanë hyrë në ambientet e teatrit dhe kanë shkuar në zyrën e financës, duke vjedhur paratë e kasafortës. Sipas policisë, hajdutët kanë marrë 4500 euro, të cilat i përkasin financieres së teatrit. Ajo i kishte lënë paratë për ruajtje në zyrën e saj.

Bastisën marketin, policia në kërkim të katër hajdutëve

POGRADEC - Mëngjesin e djeshëm, persona ende të paidentifikuar kanë vjedhur një minimarket në lagjen nr.2 të qytetit të Pogradecit. Burime nga policia lokale pohuan se "dyskohet se kanë qenë katër persona, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin, pasi kanë marrë kasafortën me një sasi lekësh janë larguar me shpejtësi nga vendngjarja. Po pumohet për identifikimin, kapjen e autorëve si edhe dokumentimin e plotë të ngjarjes".

Gjenden 2 predha luftarake, do të shiteshin për skrap

KUKËS - Dy predha luftarake janë gjetur dje nga një grup fëmijësh në lagjen nr.3 të qytetit të Kukësit. Pas sinjalizimit, shërbimet e policisë shkuan në vendngjarje ku konstatuan në një karruocë dy predha mortaje të parrezikshme dhe një predhë pak më tutje. Sipas bluve, predhat, të cilat do të asgjësohen, ishin gjetur pranë një ish-repartit ushtarak dhe ishin marrë për t'u shitur për skrap.

50-vjeçari, kreu i grupit kriminal që u godit të shtunën. U dënua për një vrasje të dyfishtë në '99-ën

Jeta luksoze e tutorit të prostitutave, Rinard Tota

Babai i dy fëmijëve shoqërohej me dy femra dhe postonte foto intime


Senad Nikshiqi

SHKODËR

Rinard (Frederik) Tota, i cili u arrestua të shtunën së bashku me 6 të tjerë për shfrytëzim prostitucioni, para pak muajsh bëri bujë në media dhe rrjetet sociale duke u bërë një emër i njohur jo vetëm në Shkodër. Prej disa vitesh, 50-vjeçari posedonte lokalitë në tij "Tata", ku organizonte muzikë live, por edhe ofronte balerinë për të kërcyer, për të kënaqur më shumë klientët. Ai është dënua më parë disa herë, ndërsa së fundmi u arrestua nga policia e Shkodrës si koka e një grupi prostitucioni. Frederik Tota ose Tata, siç e njohin në qytetin verior bënte një jetë të shtrenjtë. Prej kohësh, edhe pse është baba i dy fëmijëve, ai shoqërohej me dy femra. 50-vjeçari postonte fotografi me dy vajzat kudo që shkonte, deri edhe në foto intime. Gjithnjë mbante në qafë dhe duar bizhuteri floriri me vlera të konsiderueshme e po ashtu, edhe makina të shtrenjta, me të cilat lëvizte. Para pak kohësh pikërisht për shoqërimin e tij me dy femra u bë edhe viral në rrjetet sociale, duke treguar jetën e shtrenjtë dhe rrethimin nga femrat. Shpeshherë femrat me të cilat shoqërohej postonin foto të zhveshura dhe të mbuluar plot me para me prerje të ndryshme. Lokali i Frederik Tatës në lagjen "Xhabie" në Shkodër shërbente më shumë në orët e vona, kur edhe organizohej muzika live me këngëtarë e balerina. Këto të fundit sipas policisë nuk kishin rolin e balerinave, por të prostitutave, duke marrë para në këmbim të marrëdhënieve seksuale me klientët.

ARRESTIMI

Katër ditë më parë, në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit", policia e Shkodrës në bashkëpunim me prokurorinë e këtij rrethi goditi një grup kriminal. Në pranga kanë rënë 7 persona, si dhe një tjetër është proceduar në gjendje të lirë, duke finalizuar me sukses operacionin e koduar "Balerina". Drejtori i policisë vendore të Shkodrës, Gjovalin Loka bëri të ditur përmes një deklarate se kreu i këtij grupi të prostitucioni është pikërisht 50-vjeçari Rinard (Frederik) Tota, i dënua më parë disa herë për vepra penale të ndryshme. "Shtetasi Rinard Tota dyshohet se ishte organizator i kësaj veprimtarie kriminale, ku prej



50-vjeçari Rinard (Frederik) Tota

VRASJA E DYFISHTË

Rinard (Frederik) Tota është një emër i njohur për drejtësinë. Ai së bashku me Behar Bajrin është akuzuar për vrasjen e vëllezërve Artur e Osman Alibali. Ngjarje kjo e ndodhur më 14 janar të vitit 1999 në lagjen "Vojo Kushi" të Shkodrës. Tota u arrestua me akuzën e bashkëpunëtorit dhe qëndroi 5 vite në burg, por më pas u lirua sërisht me vendim gjykatë, për shkak të mungesës së provave.

MILITANTI I PD-SË

50-vjeçari nga Shkodra, Rinard (Frederik Tota) mësohet se ka qenë militant i Partisë Demokratike dhe një prej mbështetësve të çadrës së protestës. Ai së bashku me dy vajzat që shfrytëzonte për prostitucion ka qenë pjesë e protestës së PD-së para Kryeministrit.

vjeç, banues në Shkodër, i dënua disa herë për vepra të ndryshme penale; Kastriot Musa, 41 vjeç, banues në fshatin Barbullush Shkodër; S.M., 32 vjeçe, banuese në qytetin e Shkodrës, e dënua më parë për veprën penale ushtrim prostitucioni; A.M., 33 vjeçe, banuese në Shkodër; A.L., 33 vjeçe banuese në Burrel; A.N., 25 vjeçe, banuese në Lezhë dhe A.M., 33 vjeçe, banuese në Shkodër. Ndërkaq, është proceduar në gjendje të lirë shtetasi K.N., banues në qytetin e Shkodrës. Sipas burimeve policore, dyshohet që Rinard Tota ishte organizator i kësaj veprimtarie kriminale ku prej kohësh shfrytëzonte për ushtrim prostitucioni shtetasit e sipërpërmendura, në lokalitë në tij "Tata", në qytetin e Shkodrës. Sakaq, në cilësinë e provave materiale janë sekuestruar ambienti trekatësh në pronësi të shtetasit Rinard (Frederik) Tota, në të cilin realizohej veprimtaria kriminale; dy automjete tip "Benz" dhe "Land-Rover" në pronësi të

Totës, një pistoletë, shtatë ora dore, një sasi e konsiderueshme bizhuterish floriri të ndryshme, një laptop dhe 8 telefona celularë të markave të ndryshme si dhe një sasi parash të fituara nga ky aktivitet kriminal në prerje të ndryshme lekë, euro, dollarë etj. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për veprat

PERSONAT E ARRESTUAR GJATË OPERACIONIT "BALERINA"

1. Rinard Tota, 50 vjeç, Shkodër
2. Kastriot Musa, 41 vjeç, Shkodër
3. S.M., 32 vjeçe, Shkodër
4. A.M., 33 vjeçe, Shkodër
5. A.L., 33 vjeçe Burrel
6. A.N., 25 vjeçe, Lezhë
7. A.M, 33 vjeçe, Shkodër

penale: "Prostitucioni", "Shfrytëzim prostitucioni", "Mbahje e ambienteve për prostitucion" dhe "Pastrim produktesh të veprës penale". Policia e Shtetit po vijon punën intensive në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit" për realizimin e plotë të objektivit për shkatërrimin e të gjitha grupeve të skeduara kriminale dhe sekuestrimin e aseteve të tyre financiare.

Shkatërrohet rrjeti i prostitucionit në Itali, drejtohej nga shqiptarët

ITALI - Policia italiane ka shkatërruar një rrjet prostitucioni, që drejtohej nga shtetas shqiptar. Xhironja e prostitutave ishte aktive sidomos në orët e mbrëmjes dhe natën në rrugën "Carlo III", një rrugë e gjerë që kalon disa nga komunat e Casertas, duke përfunduar vetëm disa hapa nga Reggia di Caserta. Kjo gjë është verifikuar nga hetimi i



koordinuar nga Prokuroria e Santa Maria Capua Vetere,

që ka çuar dje në ekzekutimin e urdhër-arresteve për 9 të hetuar, 5 me burg, 1 në arrest shtëpie, 2 detyrim paraqitje dhe për një tjetër ndalimin e banimit në provincën e Casertas. Hetimi nxori në dritë një rrjet të madh të shfrytëzimit të prostitutave të kombësive të ndryshme, të paktën 15 femra të identifikuar.

IN MEMORIAM

Fatmira Nikolli

LAMTUMIRË ALEKSANDËR LALO!

Rrëfimi i një mbrëmjeje vallëzimi në Tamarë

Ngushëllojnë miq, kolegë e politikanë për kompozitorin që la një fond të artë muzike

Petrit Ruka: Kam një lëmsh në zemër, do të më marrë malli deri në frymën e fundit

Embaj mend Aleksandrin kur ishim maturantë e kishim shkuar në Tamarë të hapnim rrugën e Malësisë së Madhe, në vitin 1967". Eleni Laperi, studiuese e artit pamor, e kujton Aleksandër Lalon adoleshent e me fizarmonikë, tani, kur në moshën 68-vjeçare, na ka lënë krejt papritur. Si Laperi, si Lalo, atëkohë, qenë maturantë. Një grup prej tri gjimnazëve të Tiranës qenë bashkuar në Tamarë. "Flinim në vathët e ndërtuar buzë lumit Cem", - kujton Eleni. "Ne ishim 14 vajza maturante të gjimnazit 'Qemal Stafa', që flinim në një çadër të vogël ushtrie, të montuar anës një sheshi të vogël".

Kujton se në mbrëmje Aleksandri ulej në një karrige buzë atij sheshi, me fizarmonikën mbi gjunjë dhe niste të luante melodi të ndryshme. Vajza e djem mblidheshin përreth e niste mbrëmja e vallëzimit. "Ashtu e mbaj mend unë Aleksandër Lalon, që na zbulonte mbrëmjet mes maleve, buzë lumit Cem", - thotë Eleni Laperi.

Ndarja nga jeta në mënyrë të parakohshme e kompozitorit të shquar Aleksandër Lalo, ka tronditur mbarë opinion publik. Personalitete të shumta të botës së artit e politikës kanë shprehur hidhërim për shuarjen e Maestro Lalos, i cili ndërroi jetë të dielën në moshën 68 - vjeçare nga një atak në zemër. Në homazhet e mbajtura të hënën në RTSH, të shumtë qenë ata që ngushëlluan familjen.

Miku i tij më i mirë, Petrit Ruka, që ishte me të në spital deri në castin e fundit, ndihej ende shumë i dobët. "LALO I SHTRENTJË", nuk fle dot, sepse: 'Kam një lëmsh në zemër' dhe nuk e them dot kurrë më mirë se ç'e ke thënë ti me tinguj të ky krijim i mrekullueshëm, që vetë ta pata sugjeruar, kur të solla këtë tekst të përpunuar popullor dhe ti krijove këtë kryeveprë që nuk do të vdesë kurrë... Krijim i pavdekshëm si një homazh nderimi për një nga shpirtat më të bukur që kam njohur në këtë botë dhe që të cilin do të jem krenar e do të më marrë malli deri në frymën e fundit të jetës sime...."

RRËFIMI PËR NJË NATË PARA NJË GOTE

Elton Deda kujton se zakonisht e takonte me humor të mirë. "Shpesh më merrte në telefon dhe më thoshte: 'Mos e lër krijimtarinë pas dore'. Një natë u ulem dhe morëm nga një fërnë. Folëm gjatë me miq për hallet e panumërta që kanë artistët këtu", - thotë ai. Shënon se sot, kur ai nuk është më ka ndërmend t'i buzëqeshë jetës dhe jo t'i mbajë mëri se u dorëhoq prej tij. "Ashtu është ajo, ka qejf të bëjë kapriço ndonjëherë e kur i do qejfi, si ato femrat xanxare. Ti ishe miku i babait tim, ishe miku im, ishe miku i gjithë muzikantëve të ndërshej. T'i ishe miku i muzikës, ti ishe unikali me shpirt të brishtë dhe i përkëdheluri i Perëndisë", - thotë Deda dhe mandej, i jep disa porosi të fundit: "Mos harro të puaosh me korin e engjëjve atje ku u nise mbrëmë. Dhe je i lutur që mos t'i marrësh as Zotit leje nëse do të shkosh të bësh drekën. Lamtumirë, o i madhi Sandër Lalo!".



Në foto:
Kompozitori
Aleksandër Lalo

Artisti i pa kompromis që ndër të paktët që qe përplatur edhe me ministrin e Kulturës Mirela Kumbaro. Megjithatë, Kumbaro dje shkroi se "Muzika shqiptare hedh vëllon e zisë në prag të dimrit të fundit të kompozitorit më energjik. Lamtumirë Aleksandër Lalo!"

ÇFARË LA PAS

Aleksandër Lalo është një ndër emrat më të shquar të muzikës shqiptare që ka lënë pas një fond të artë muzike si në muzikën e filmave edhe në atë të këngëve në festivale.

"Pas '90 kam bërë muzikën vetëm të një filmi 'Tingujt e harresës' dhe muzikën e një dokumentari për Ismail Kadare. Behën pak filma, sigurisht që dhe nuk na kanë afruar. Vërej një gjë, që faktorit muzikë nuk i është kushtuar rëndësi në filma", - shprehej Lalo, pak kohë më parë. Ai thoshte se, për shkak të anës financiare, muzika është lënë pas dore, kur dihet që muzika ka funksion të rëndësishëm në film. "Shqipëria në muzikën e filmit ka marrë shumë vlerësime dhe nga të huajt. Ka autorë akoma gjallë që kanë shkruar muzikë filmash si Limoz Dizdari, Haig Zacharian, Aleksandër Peçi, etj., që nuk i shoh të afruar në filma. Regjisorët duhet të jenë pak më të vëmendshëm ndaj profesionistëve", -



DISA NGA KOMPOZIMET E ALEKSANDËR LALOS:

- ☉ "Tingujt e harresës" (1996) (TV)
- ☉ "Historiani dhe kameleoni" (1989)
- ☉ "Treni niset më shtatë pa pesë" (1988)
- ☉ "Dy herë mat" (1986)
- ☉ "Fjalë pa fund" (1986)
- ☉ "Asgjë nuk harrohet" (1985)
- ☉ "Fushë e blertë fushë e kuqe" (1984)
- ☉ "Era e ngrohtë e thellësive" (1982) (TV)
- ☉ "Një vonesë e vogël" (1982)
- ☉ "Shi në plazh" (1982)
- ☉ "Shtëpia jonë e përbashkët" (1981)
- ☉ "Thesari" (1981)
- ☉ "Gëzhoja e vjetër" (1980)
- ☉ "Nusja" (1980)
- ☉ "Vajzat me kordele të kuqe" (1978)
- ☉ "Tomka dhe shokët e tij" (1977)
- ☉ "Dimri i fundit" (1976)
- ☉ "Emblema e dikurshme" (1976) (TV)
- ☉ "Duke kërkuar 5-orëshin" (1974)
- ☉ "Odiseja e tifozëve" (1972)
- ☉ "Të shoh në sy" (1986)
- ☉ "Një gjeneral kapet rob" (1980)

Dje, Robert Radoja e cilësoi si kompozitorin e tingujve të gëzueshëm, ndërsa Ardit Gjebreja, në një reagim në rrjetet sociale shkroi: "Eh çfarë kompozitori humbëm sot... dhe sa shpejt... Paqe për ty i dashur Aleksandër Lalo dhe mirënjohje për muzikën që na dhurove!".

I shokuar nga ky lajm u shpreh

edhe Shpëtim Saraçi, i cili po në rrjetet sociale shkroi: "Sandër të njohën pak. Të faleminderit për gjithçka na trashëgove. Do kemi mall për gjithçka tënden. E kishim lënë që do bënim 1 koncert të madh LIVE së bashku... Na e bëre me hile... Jeta kjo qenka i dashur Sandër. Pushofsh në paqe mik i dashur!".

POLITIKA

"Ndarja nga jeta e kompozitorit tonë të shquar Aleksandër Lalo përbën një humbje për botën e muzikës dhe kulturës. Por veprat e tij frymëzuese do mbeten përgjithmonë", - ishte mesazhi që Presidenti i Republikës, Ilir Meta përcolli për ndarjen nga jeta të Lalos.

"Aleksandër Lalo, poeti i tasterës u nda nga jeta duke lënë pas një pemë të bukur mbushur plot me cicërima. U prehtë në paqe!", shkroi Kryeministri Edi Rama, në mesazhin e tij të ngushëllimit.

Edhe kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha shprehu ngushëllimet e tij për ndarjen nga jeta të Lalos.

"Një lamtumirë e parakohshme për Mjeshttrin e tingujve, Aleksandër Lalo. Arti humbi kompozitorin që krijoi çdo tingull me dëshirë dhe pasion. Artistët humbën avokatit kurajoz të të drejtave të tyre. Ne humbëm mjeshttrin virtuoz me muzikën e të cilit u rritën dhe u dashuruar brezat për disa dekada. Lamtumirë Maestro! "Tingujt e harresës" nuk do të luhen kurrë për ty!", shkroi Basha.

vërente ai. Shtonte se "Bie në sy se në të gjitha aktivitetet ka vulgaritet në tekstet e këngëve".

Projekti i tij i fundit, ishte pjesë-marrja në panelin e jurisë së spektaklit "C'est la vie" në Tv Klan, ku krahas kritikave profesionale, shquhej për batutat dhe humorin që e karakterizonte Aleksandër Lalo.

Si autor i muzikës së shumë filmave të kinematografisë shqiptare, që kanë mbetur ndër vite në memorien e publikut, kujtojmë muzikën për filmat: "Dimri i fundit", "Dy herë mat", "Treni niset në shtatë pa pesë", "Shi në plazh", "Vajzat me kordele të kuqe", "Tingujt e harresës", "Era e ngrohtë e thellësive", "Emblema e dikurshme", "Një gjeneral kapet rob" etj. Gjithashtu, ai ka qenë kompozitor i disa këngëve që kanë marrë çmime në festivale të RTSH. Ai lindi më 27 prill të vitit 1949, në Tiranë, por vinte nga një familje me origjinë nga Leskoviku. Gjatë konkurrencimit me kompozimet e tij në festivale kryesisht arriti vende të dyta megjithëse meloditë e tij janë konsideruar të mrekullueshme.

PERVJETORI



E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit, gruaja që u vra shtatzënë

Përvjetori i ekzekutimit pas gjyqit të vitit 1946, AIDSSH zbardh dokumentet

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Institutin e Historisë dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike organizon takimin "E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit". Takimi mbahet sot në sallën e konferencave të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Aktiviteti përkujton të dënuarit që punuan për tharjen e kënetës të Maliqit, në përvjetorin e ekzekutimit të tyre pas gjyqit të hapur në nëntor të 1946.

Takimi çelët me fjalën e mirëseardhjes së Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë, asoc. prof. Gëzim Hasko. Kryetarja e AIDSSH, Gentiana Sula, mban fjalën e rastit mbi nismën e Autoritetit në organizimin e takimeve përkujtimore që hedhin dritë mbi të shkuarën, duke ridimensionuar raportin tonë dhe të shoqërisë me të vërtetën. Takimi dhe diskutimet, theksojnë nevojën për t'u përballur me transparencë me të shkuarën, duke konsoliduar demokracinë.

Në vijim prezantohen punimet shkencore të përfaqësuesve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike. Familjarë të të ekzekutuarve përshëndesin të ftuarit, trashëgimtarë të të dënuarve, historianë e studentë, përfaqësues të institucioneve publike e joqeveritare, organizatave kombëtare e ndërkombëtare. Për takimin përkujtimor, AIDSSH ka zbardhur materialet arkivore që gjenden për këtë gjyq, përmes një CD me materialet e dixhitalizuara dhe zotëron një dosje të plotë me

lëndë arkivore, foto, studime për ngjarjen dhe pjesë filmike për të.

E ashtuquajtura "organizatë tekniko-sabotatore" përbëhej nga Abdyl Sharra, 35 vjeç, kryeinxhinier në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit, i akuzuar si "iniciatori kryesor i sabotimeve në stil të gjerë për ndërmarrjet e mëdha që bënte pushteti popullor"; Kujtim Beqiri, 30 vjeç, bir i një familjeje patriotike, medalje e artë në inxhinieri civile në Universitetin e Vjenës, drejtor në punimet e Maliqit; Vasil Mano, inxhinier në kënetë, i akuzuar bashkë me të shoqen Zyrikën (e cila u pushkatua shtatzënë), për lidhje dhe kontakte të herëpashershme me agjentët e UNRRA-s; Pandeli Zografi dhe Mario Guarnieri, geometra në kënetën e Maliqit; Eugenio Scaturro, italian, llogaritar në Maliq; Mihal Stratobërdha, Anastas Risto dhe Jani Vasili.

Proceset gjyqësore të të pandehurve filluan më 8 nëntor 1946 dhe përfunduan pas 10 ditësh. Gjatë asaj periudhe, lajmi kryesor në vend ishte gjyqi ndaj të bujshmit

"grupi i sabotatorëve të kënetës së Maliqit". Procesi, që transmetohej publikisht me altoparant, u zhvillua në kinema "Nacional", me skenar të parapërgatitur në detajet më të vogla. Pas shpalljes së vendimit, ku u goditën disa nga figurat e shquara atdhetare e intelektuale të Shqipërisë, grupi i dënuar me vdekje u ekzekutua në Maliq, më 19 nëntor 1946. Menjëherë vijuan arrestimet në masë të rreth 80 inxhinierëve të shkollës teknike të Harry Fulzit dhe u arrit në shkëputjen e marrëdhënieve me SHBA-në e Britaninë e Madhe, për t'u bërë pjesë aktive e kampit të Lindjes komuniste.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to, bazuar në ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

1946/Dekreti i vdekjes për grupin e parë të inxhinierëve të Maliqit

KASTRIOT DERVISHI

Në mbledhjen nr.59, datë 19.11.1946, Presidiumi i Kuvendit Popullor vendosi refuzimin e kërkesave për faljen e jetës së bërë nga të dënuarit e procesit të parë të "Maliqit" dhe familjarët e tyre, duke urdhëruar ekzekutimin me varje në litar të Abdyl Sharrës, Kujtim Beqiri dhe me pushkatim të Vasil Manos, Zorika Manos dhe Eugenio Scaturros.

Kënetë e Maliqit nisi të thahej më 5 maj 1946. Punimet e saj duhej të mbaronin më 28 nëntor 1946, kurse, në fakt, në fazën kryesore mbaruan në vitin 1951. Drejtues të punimeve ishin Abdyl Sharra dhe Kujtim Beqiri. Proceset ndaj teknikëve për goja "sabotime" ishin kombinacione dhe legjendime të përpiluara nga teknikët jugosllavë të Maliqit dhe regjimi komunist për të përligjur largimin e misionit amerikan në Tiranë. Dosjet hetimore-gjyqësore të këtyre proceseve janë tërësisht të manipuluara nga regjimi, sepse janë marrë dhe zhvilluar në kushtet më të rënda të torturës psikike dhe fizike. Procesi i parë i Maliqit dhe proceset e tjera vijuese, synonin të implikonin qeverinë amerikane dhe diplomatit e saj Fultz. Sipas informacioneve të siguruara, Fultz, vetëm nga zhvillimi i gjyqit e kuptoi kush i kishte drejtuar punimet në Maliq.

Nga maji 1945 e deri nëntor 1946, ngjarjet janë zhvilluar kështu:

- 8 maj 1945 misioni diplomatik amerikan mbërrin në Tiranë
- 10 nëntor 1945 qeveria amerikane njohu qeverinë komuniste me kusht deri në plotësimin e kushteve, e deri në këtë kohë nuk do kishte nivel të lartë diplomatik. Dy ditë më vonë, Hoxha deklaroi se ishin djegur arkivat e nuk i njihje traktatet me SHBA-në (si injorant i politikës nuk e dinte që traktatet hartohen në disa ekzemplarë)
- 13 gusht 1946, Enver Hoxha i deklaroi shefit të misionit diplomatik amerikan se qeveria e tij do njohë disa traktate me karakter dypalësh, vetëm pas njohjes së Shqipërisë nga SHBA.
- 20 shtator 1946, sekretari i shtetit, udhëzoi mosnjohjen e qeverisë komuniste të Hoxhës.
- 28 shtator 1946 nisën arrestimet në Maliq.
- 8 deri më 18 nëntor 1946 zhvillohet procesi i parë kundër "sabotatorëve".
- 15 nëntor 1946 misioni amerikan largohet nga Shqipëria.
- 19 nëntor 1946 ekzekutimi në Maliq i grupit të parë.



GIFFONI SHQIPËRIA/ NIS FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I FILMIT PËR TË RINJ DHE FËMIJË

Ka filluar dje zyrtarisht edicioni i 12-të i festi Kvalit ndërkombëtar të filmit për të rinj dhe fëmijë, Giffoni Shqipëria. Në 4 ditë festival shfaqen 8 filma, mes tyre 4 prodhime shqiptare. E veçanta e këtij festivali është përfshirja e nxënësve që nuk ftohen thjesht për të parë filmin, por janë të gjithë juri. Një juri e stërmadhe prej 250 nxënësish nga shkollat nëntëvjeçare të Tiranës të moshës 13-15 vjeç ishte ajo e sotshmeja e filmit të parë të Giffoni Shqipëria, një prodhim kinematografik gjerman me titull; "AT EYE LEVEL" dhe me regji të Evi Goldbrunner dhe Johachim Dollhoff. Por filmi i dytë, një produksion lituanez me titullin "MELLOW MUND" me regji të Renars Vimba, u gjykua nga një

tjetër juri, po aq e madhe që mbushi një sallë të tërë me 250 nxënës të tjerë, kësaj here të shkollave të mesme publike të Tiranës, nga moshë 16-20 vjeç.

Sot në orën 18:30, pranë Kinema Millennium, Giffoni Shqipëria organizoi një kokteil dhe ceremoninë e hapjes zyrtare të edicionit të 12-të të Giffon Shqipëria, me personalitete të ndryshme të artit, kinematografisë, kulturës, etj., kurse në datën 24, ora 11:00 do të mbahet dhe ceremonia e ndarjes së çmimeve. Filmata që do të shfaqen në këtë edicion të 12-të do të kenë një risi ndryshe nga vitet e shkuara. Në konkurrim do të jenë dhe filma shqiptarë, prodhime të realizuara nga moshat 6 deri 20 vjeç, të ndara në sesione të ndryshme dhe të gjykuara nga juri të ndryshme.

Miratohet shtesa e fondit për dëmshpërblimet e familjeve të dëmtuara nga lëkundjet e tokës

Dëmet në Zharrës, lista me përfituesit e 172 milionë lekëve

"Bankers Petroleum Albania" paguan 101 milionë lekë

Ornela Manjani

Qeveria shqiptare miraton kompensimin e familjeve të prekura nga lëkundjet e tokës. "Gazeta Shqiptare" boton listën e përfituesve dhe shumën e kompensimit për çdo familje. Fondi i vënë në dispozicion arrin në rreth 172 milionë lekë. Vendimi që është publikuar në Fletoren Zyrtare në pikën e parë të tij parashikon që Bashkisë Patos në buxhetin e vitit 2017 do t'i shtohet fondi prej 172 868 638 lekësh, për dëmshpërblimin e 71 (shtatëdhjetë e një) familjeve, banesat e të cilave janë shkatërruar nga lëkundjet e tokës në fshatrat Zharrës dhe Dukas. Bashkisë Roskovec në buxhetin e vitit 2017 do t'i shtohet fondi prej 2 297 247 lekësh, për dëmshpërblimin e 1 familjeje, banesa e së cilës është shkatërruar nga lëkundjet e tokës në fshatin Marinëz. Sipas vendimit, dëmshpërblimi do të jetë sipas listave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me emrat e individëve dhe shumën përkatëse të dëmshpërblimit. Fondi i përgjithshëm prej 175 165 885 lekësh do të çelë për Bashkitë Patos dhe Roskovec dhe të përballohet si më poshtë vijon: a) Nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, në masën 73 992 071 lekë. b) Nga "Bankers Petroleum Albania", në masën 101 173 814 lekë. Këshilli i Ministrave ka vendosur që kryerja e pagesave për personat përfitues, banesat e të cilave janë shkatërruar plotësisht nga lëkundjet e tokës të bëhet nga Bashkitë Patos dhe Roskovec. Ndërkohë që ngarkohen Ministria e Financave dhe Energjisë, Enti Kombëtar i Banesave, Institucioni i Prefektit të qarqut Fier, Bashkia Patos dhe Bashkia Roskovec për zbatimin e këtij vendimi.

LISTA EMËRORE E FAMILJEVE NE FSHATIN DUKAS DHE ZHARRËZ, BANESAT E TË CILËVE JANË SHKATËRRUAR PLOTËSISHT, SIPAS VLERESIMIT TË BËRË NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, BASHKIA PATOS

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Fshati	Sip. faktike	Kosto mesatare e ndërimit	Vlera e dëmit sipas EKB	Vlera e dëmshpërblimit	Kontributi i Shtetit	Kontributi Bankers
1	Rajmonda Isat Balla	Dukas	38.1	31,599	1,203,921.90	1,203,921.00	601,961.00	601,960.00
2	Maliq Gani Musabelliu	Dukas	52	31,599	1,643,148.00	1,643,148.00	821,574.00	821,574.00
3	Namik Pellumb Muçaj	Dukas	51.5	31,599	1,627,348.50	1,627,348.00	813,674.00	813,674.00
4	Kujtim Belul Dervishaj	Dukas	64.2	31,599	2,028,655.80	2,028,655.00	1,014,328.00	1,014,327.00
5	Skënder Arshin Meçi	Dukas	120	31,599	3,791,880.00	3,791,880.00	1,271,860.00	2,520,020.00
6	Barije Abas Hajdini	Zharrëz	104	31,599	3,286,296.00	3,286,296.00	848,117.00	2,438,179.00
7	Florimont Qerem Plumbi	Zharrëz	104	31,599	3,286,296.00	3,286,296.00	1,271,860.00	2,014,436.00
8	Hekuran Rrapi Lisi	Zharrëz	71	31,599	2,243,529.00	2,243,529.00	1,121,765.00	1,121,764.00
9	Zyber Dajlan Muska	Zharrëz	109	31,599	3,444,291.00	3,444,291.00	1,271,860.00	2,172,431.00
10	Luftar Dalip Rexhepi	Zharrëz	72	31,599	2,275,128.00	2,275,128.00	1,137,564.00	1,137,564.00
11	Safigje Lymo Lisi	Zharrëz	125	31,599	3,949,875.00	3,949,875.00	892,198.00	3,057,677.00
12	Nizajete Abedin Bani	Zharrëz	124	31,599	3,918,276.00	3,918,276.00	1,271,860.00	2,646,416.00
13	Besnik Rauf Grembi	Zharrëz	118	31,599	3,728,682.00	3,728,682.00	1,259,853.00	2,468,829.00
14	Hatem Ibrahim Sinjati	Zharrëz	87	31,599	2,749,113.00	2,749,113.00	1,374,557.00	1,374,556.00
15	Arçile Todi Ngjeliu	Zharrëz	42	31,599	1,327,158.00	1,327,158.00	663,579.00	663,579.00
16	Erion Bektaş Sinaj	Zharrëz	82	31,599	2,591,118.00	2,591,118.00	848,118.00	1,743,000.00
17	Abaz Kadri Kothere	Zharrëz	87.3	31,599	2,758,592.70	2,758,592.00	1,259,852.00	1,498,740.00
18	Andon Qani Belulaj	Zharrëz	55	31,599	1,737,945.00	1,737,945.00	868,972.00	868,972.00
19	Nimete Arif Brace	Zharrëz	80	31,599	2,527,920.00	2,527,920.00	1,263,960.00	1,263,960.00
20	Sheko Refat Asllani	Zharrëz	59	31,599	1,864,341.00	1,864,341.00	932,171.00	932,170.00
21	Gentian Dano Asllani	Zharrëz	56	31,599	1,769,544.00	1,769,544.00	884,772.00	884,772.00
22	Artur Koli Nasto	Zharrëz	94.8	31,599	2,995,585.20	2,995,585.00	1,259,852.00	1,735,733.00
23	Rronje Osman Baha	Zharrëz	79	31,599	2,496,321.00	2,496,321.00	1,248,161.00	1,248,160.00
24	Uane Todi Koliçi	Zharrëz	95	31,599	3,001,905.00	3,001,905.00	1,259,853.00	1,742,052.00
25	Keze Hekuran Rama	Zharrëz	79	31,599	2,496,321.00	2,496,321.00	1,248,161.00	1,248,160.00
26	Bilbil Maharem Djellaj	Zharrëz	82	31,599	2,591,118.00	2,591,118.00	892,198.00	1,698,920.00
27	Fecor Kadri Sedri	Zharrëz	67	31,599	2,117,133.00	2,117,133.00	1,058,567.00	1,058,566.00
28	Artjan Sadik Baha	Zharrëz	72	31,599	2,275,128.00	2,275,128.00	1,137,564.00	1,137,564.00
29	Lushë Hysen Musta	Zharrëz	75	31,599	2,369,925.00	2,369,925.00	848,118.00	1,521,807.00
30	Arben Feik Hoxha	Zharrëz	78.6	31,599	1,516,752.00	1,516,752.00	758,376.00	758,376.00
31	Deko Hekuran Kothere	Zharrëz	77.2	31,599	2,439,442.80	2,439,442.00	1,219,721.00	1,219,721.00
32	Thanas Stegjo Kazani	Zharrëz	56.47	31,599	2,559,519.00	2,559,519.00	892,198.00	1,667,321.00
33	Petref Jashar Kothere	Zharrëz	120	31,599	3,791,880.00	3,791,880.00	1,271,860.00	2,520,020.00
34	Musa Barjam Rama	Zharrëz	95	31,599	3,001,905.00	3,001,905.00	1,259,853.00	1,742,052.00
35	Ardjan Muço Velaj	Zharrëz	113	31,599	3,570,687.00	3,570,687.00	1,271,860.00	2,298,827.00
36	Asllan Rustem Asllani	Zharrëz	66	31,599	2,085,534.00	2,085,534.00	1,042,767.00	1,042,767.00
37	Leksandra Vasil Nasto	Zharrëz	106	31,599	3,033,504.00	3,033,504.00	1,516,752.00	1,516,752.00
38	Fitim Ramadan Hajdini	Zharrëz	72	31,599	2,275,128.00	2,275,128.00	1,137,564.00	1,137,564.00
39	Fejide Faik Vrapi	Zharrëz	123	31,599	3,886,677.00	3,886,677.00	1,271,860.00	2,614,817.00
40	Namik Alush Qulli	Zharrëz	108	31,599	3,412,692.00	3,412,692.00	1,271,860.00	2,140,832.00
41	Qemal Telko Belulaj	Zharrëz	88.2	31,599	2,787,031.80	2,787,031.00	1,393,516.00	1,393,515.00
42	Shyqeri Ramadan Grembi	Zharrëz	56.47	31,599	2,938,707.00	2,938,707.00	892,198.00	2,046,509.00
43	Teki Elmas Bani	Zharrëz	106	31,599	3,349,494.00	3,349,494.00	1,271,860.00	2,077,634.00
44	Xheva Nazif Jajaj	Zharrëz	93	31,599	2,938,707.00	2,938,707.00	892,198.00	2,046,509.00
45	Luto Jonus Asllani	Zharrëz	70	31,599	2,211,930.00	2,211,930.00	892,198.00	1,319,732.00
46	Jorgaq Llambi Shollo	Zharrëz	44	31,599	1,390,356.00	1,390,356.00	695,178.00	695,178.00
47	Halit Shaban Grembi	Zharrëz	72	31,599	2,275,128.00	2,275,128.00	1,137,564.00	1,137,564.00
48	Miti Todi Koliçi	Zharrëz	15.6	31,599	492,944.40	492,944.00	246,472.00	246,472.00
49	Albert Luto Lazaj	Zharrëz	77.4	31,599	2,445,762.60	2,445,762.00	1,222,881.00	1,222,881.00
50	Luftar Alush Qulli	Zharrëz	51.5	31,599	1,627,348.50	1,627,348.00	813,674.00	813,674.00
51	Sokrat Todi Koçi	Zharrëz	40	31,599	1,263,960.00	1,263,960.00	631,980.00	631,980.00
52	Viktor Fecor Grembi	Zharrëz	49.5	31,599	1,564,150.50	1,564,150.00	782,075.00	782,075.00
53	Vangjel Pilo Terezini	Zharrëz	113	31,599	3,570,687.00	3,570,687.00	1,271,860.00	2,298,827.00
54	Vili Jakup Jajaj	Zharrëz	75.7	31,599	2,392,044.30	2,392,044.00	1,196,022.00	1,196,022.00
55	Rraso Dalip Beluli	Zharrëz	66.7	31,599	2,107,653.30	2,107,653.00	1,053,827.00	1,053,826.00
56	Mustafa Ibrahim Sinjati	Zharrëz	57	31,599	1,801,143.00	1,801,143.00	900,572.00	900,571.00
57	Fecor Dalip Behuli	Zharrëz	43.1	31,599	1,361,916.90	1,361,916.00	680,958.00	680,958.00
58	Ermal Hetem Hoxhaj	Zharrëz	74	31,599	2,338,326.00	2,338,326.00	892,198.00	1,446,128.00
59	Hysnie Elmas Hadaj	Zharrëz	58	31,599	1,832,742.00	1,832,742.00	916,371.00	916,371.00
60	Haxhire Ramadan Bani	Zharrëz	81.2	31,599	2,565,838.80	2,565,838.00	1,271,859.00	1,293,979.00
61	Ferdinand Todi Koliçi	Zharrëz	88.7	31,599	2,802,831.30	2,802,831.00	1,271,860.00	1,530,971.00
62	Agur Veip Diellaj	Zharrëz	70	31,599	2,211,930.00	2,211,930.00	892,198.00	1,319,732.00
63	Sadik Dano Baha	Zharrëz	70	31,599	2,211,930.00	2,211,930.00	1,105,965.00	1,105,965.00
64	Altin Agim Vrapi	Zharrëz	53.4	31,599	1,687,386.60	1,687,386.00	843,693.00	843,693.00
65	Marin Edmond Nikolla	Zharrëz	78.4	31,599	2,477,361.60	2,477,361.00	848,117.00	1,629,244.00
66	Zengjel Murat Grembi	Zharrëz	25	31,599	789,975.00	789,975.00	394,988.00	394,987.00
67	Hamit Ramadan Grembi	Zharrëz	84	31,599	2,654,316.00	2,654,316.00	1,327,158.00	1,327,158.00
68	Osmen Haxhi Fetahu	Zharrëz	91.2	31,599	2,881,828.80	2,881,828.00	1,259,852.00	1,621,976.00
69	Daut Refat Grembi	Zharrëz	21	31,599	663,579.00	663,579.00	331,790.00	331,789.00
70	Ymer Nuri Diellaj	Zharrëz	67	31,599	2,117,133.00	2,117,133.00	1,058,567.00	1,058,566.00
71	Elmaz Rrapush Asllani	Zharrëz	109	31,599	3,444,291.00	3,444,291.00	892,198.00	2,552,093.00
					172,868,649.30	172,868,638.00	72,843,448.00	100,025,190.00

Lista emërore e familjeve ne fshatin Marinëz dhe Kuman, bashkia Roskovec, banesat e të cilëve janë shkatërruar, sipas vleresimit të bërë nga Enti Kombëtar i Banesave

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Fshati	Sip. faktike	Kosto mesatare e ndërimit	Vlera e dëmit sipas EKB	Vlera e dëmshpërblimit	Kontributi i Shtetit	Kontributi Bankers
1	Nesti Pandi Nushi	Marinëz/Kuman/Roskovec	72.7	31,599.00	2,297,247	2,297,247	1,148,623	1,148,624
						175,165,885.00	73,992,071.00	101,173,814.00

GODITJA E SHKRIMTARIT

Dosja gjyqësore e Trebeshinës u akuzua për pikëpamje armiqësore

Prof. asoc. dr. Anila Mullahi*

Kasëm Trebeshina filloi të shkruajë herët, që në 1951. Kemi një sërë poezish të tij të botuara në gazetën "Letrari ri" si dhe një sërë dramash "Heronjtë" në '52 dhe "Shtrojnë malet" në '53. Gjatë vitit 1953, në "Letërsia jonë", organi i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, në numrin 3, 5, 6, etj, u botuan nga Trebeshina, një sërë poezish, dhe në nr. 10 u botua një dramë me 5 akte, "Kruja e çliruar". Botimet e krijimeve të tij në periodikët kryesorë letrarë të kohës, (prozë dhe poezi), tregojnë se kemi të bëjmë me një shkrimtar prodhimtar që ka nisur të njihet në radhët e shkrimtarëve dhe lexuesve. Trebeshina filloi të shkruante në një periudhë kohe kur goditjet e herëpashershme ndaj letërsisë dhe shkrimtarëve kishin ndikuar negativisht dukshëm në cilësinë e letërsisë, por kjo shfaqësojë nëpërmjet argumenteve si "letërsia është çështje shtetërore". Në një mbledhje të organizuar në Lidhje në vitin 1953, diskutimet rreth poezive të tij, ngjajnë të turpshme dhe qesharake. Dikujt nuk i pëlqen që ai bën "objekt të poezisë së tij vajzën syzezë", si dikur Hajne, por që tashmë sipas tyre, objekte të tilla poezia e realizmit socialist i kishte tejkaluar kohë më parë. Dikush, në mënyrë gati naive, shpreh se "nuk e kuptojnë se çfarë thotë në shkrimet e tij", "nuk e kuptojnë aspak filozofinë e tij të shkruarit", dikush e akuzon për anakronizëm, sepse është i paaftë të shkruajë për temat dhe optimizmin e kohës, por sepse shkruan vargje të tilla si "mëzri në errësirë", "s'ka jetë për mua". Sipas bashkëkohësve të tij, në momentin kur Trebeshinës iu ndaluan botimi i përmbledhjeve me poezi, në fund të mbledhjes ai dorëzoi letërën e dorëheqjes nga Partia dhe nga Lidhja. Pikërisht në këtë kohë, mendohet se shkroi promemorian që shumë të diskutuar në lidhje me problemet e letërsisë.

Trebeshina, bashkë me disa shkrimtarë të tjerë, do të përjashtohen në vitin 1954 nga Lidhja e Shkrimtarëve. Trebeshina u kritikua për: "qëndrim nihilist kundrejt letërsisë së realizmit socialist"

- se shprehej se niveli i ulët i letërsisë shqipe vinte nga "fryma e partisë në letërsi".


- se ai kërkonte të shkruante një letërsi "të përjetshme", për tema të përjetshme e "të përgjithshme"

- u kritikuan se kishin një vlerësim shumë të lartë "vetëm për letrarët e mëdhenj t'epokave të kaluara" dhe se "ata mohohte letërsinë sovjetike, klasikët e saj".

- akuzat për kozmopolitizëm është një nga më të fortat që i janë bërë shkrimtarit,

- u kritikua për pikëpamjen e tij për një art "të pa kondicionuar", "jashtë kohës e klasave", si dhe për përpjekjet për të "fetishizuar formën".

Trebeshina kishte studiuar jashtë dhe e njihje mirë letërsinë



Në foto: Kasëm Trebeshina

klasike, duke qenë në gjendje ndërkaq të kuptonte fare mirë nivelin e ulët të letërsisë që po krijohej, dhe sado që ngrihej në piedestal, ai nuk mund të mos kuptonte se letërsisë i kishte humbur poetizmi, Ai shpesh i kishte kritikuar veprat e dobëta si "artikull gazete" apo "traktat".

DËBIMI NGA LIDHJA E SHKRIMTARËVE

Në mbledhjen e 24 shkurtit të vitit 1954, Kasëm Trebeshina u vendos që të dëbohej nga Lidhja e Shkrimtarëve. Në revistën letrare-artistike, shoqërore-politike "Nëntori", të vitit 1954, për Trebeshinën i cili po vuante dënimin e parë, shkruhet:

"Partia jonë zbuloi të demaskoi pikëpamjet antipatriotike në letërsi të Kasëm Trebeshinës me shokë, të cilët mohojnë në mënyrë të hapët realizimet dhe sukseset e letërsisë sonë të re, fetishizonin të kaluarën, shtrembëronin vlerat edukuese të klasikëve, nënçmonin rëndësinë revolucionare të realizmit socialist dhe të letërsisë sovjetike dhe përpiqeshin në këtë mënyrë të godisin në këtë mënyrë fuqinë krijuese të popullit tonë, mundësitë dhe besimin e tij në ndërtimin e të sotmes heroike dhe të së ardhmes së lumtur. Këto pikëpamje janë shprehur edhe në veprat e tyre, disa prej të cilave

janë të ngjeshura me frymë kozmopolitizmi, subjektivizmi të theksuar, megalomanie dhe narcizizmi".

Në 1954 Trebeshina dënohet me 3 vjet burg me akuzën për agitacion dhe propagandë kundër pushtetit, ai u dënua sepse në biseda me "persona të rrethit të tij shoqëror ose letrar ai ka folur se donte të largohej nga atdheu i tij dhe të shkonte në një shtet borgjez si në Zvicër ku të zhvillonte talentet e tij letrare më të mira. Ai kërkonte shkojë në Zvicër që është simbol i lirisë, i të drejtave të njeriut, i asnjësisë etj. Ky është një fakt jetësor të cilin ai ka shëndërruar në një fakt letrar në veprën Odin Mondvalsen".

Trebeshina ishte një shkrimtar që u dënua edhe për veprat e pabotuara, ato në dorëshkrim. Në vendimin e gjykatës së lartë në prill të 1981, për dënimin tij merren parasysh "ekspertiza" e veprave të tij në dorëshkrim (rreth 120), të cilat i morën gjatë arrestimit në shtëpinë e tij, këto recenza shkruajnë që dorëshkrimet "pasqyrojnë rryma të ndryshme ultrareaksionare që karakterizojnë letërsinë dhe artin dekadent" në to u "gjenden pikëpamje armiqësore".

Në këtë vendim për mendend edhe një sërë titujsh, librash-dorëshkrime, të cilat na japin ndi-

Tatëpjetatat e shkrimtarit, akuzat, burg dhe vetmi

hmesë për të vërtetuar edhe njëherë kohën e shkrimit të librave të ndryshëm të Trebeshinës, shumë kohë më parë se koha e botimit që është pas viteve '90.

Dosjet hetimore të Trebeshinës na ndihmojnë për të kuptuar faktin sesi ky shkrimtar, ndonëse ishte i bindur që nuk do të botohej në atë sistem, ku burgoset e

përndiqej sistematikisht, vazhdon të shkruante pa ndalim.

Hetuesi i çështjes së tij, në 13.11.1980, kërkon që: t'i bashkëngjisë dosjes hetimore numër 257 këto vepra: "Rokoko", "Kasëti e mrekullueshme", "Kejstudi", "Meteorit i Mbretit Budurr", "Trokitja", "Ujërat dhe Brigjet", "Gjyqi", "Udhëtime fantastike", "Tiranoza-urri", si dhe shkrimet e përkthyer nga anglishtja: "Një ditë në një luftë të çuditshme", "Gjeneralët e shpirtitave të vdekur", të cilët kanë një përmbajtje të lartë armiqësore".

VEPRA, GJYQ E DËSHIMI

Përtej gjyqit, si një proces juridik, ne shohim faktet letrare, dhe Trebeshina, u dënua edhe për dorëshkrimet e tij letrare. Nga akuzat, zbulojmë se dorëshkrimet e tij nuk janë larg strukturave letrare që ne i gjejmë edhe në botimin e tyre pas viteve '90, duke vërtetuar edhe njëherë fjalët e autorit për mos ndryshim të dorëshkrimeve dhe pas botimit të tyre. Menjëherë pas '90 fillon dhe botimi i dorëshkrimeve të tij. Përmbledhja "Stina e stinëve" do të botohet në 1991 në fillim në Prishtinë e më pas me emrin "Legjenda e asaj që iku", në 1992 në Tiranë. Në këtë përmbledhje do të jetë edhe Odin Mondvalsen. Kjo veprë, nxiti interesimin e kritikës, jo vetëm për fak-

tin se erdhi nga një shkrimtar i ndaluar, por mbi të gjitha për veçantinë e formës së tij. Për mënyrën e ndërtimit të veçantë të fabulës të kronologjizuar, për specifikën e rrefimit, për problemet e receptimit, për lojën me kohën etj.

Një roman i tillë e ka zhvlerësuar modelin e endjes së subjektivit në kuptimin tradicional, kryesisht të njohur në letërsinë shqipe. Teksti shfaq shenja të forta të modernizmit dhe portmodernizmit. Romanin "Odin Mondvalsen", që në fillim, menjëherë pas botimit, nxituan ta quanin një pasqyrë të dikaturës shqiptare. Ky roman, për hir të endjes së konfliktit të tij si strukturë e hapur, merr një karakter më të përgjithshëm dhe më universal. Ai nuk kushtëzohet në kufijtë e një realiteti konkret dhe të vetëm. Ky roman u vlerësuar si një roman që "artistikisht arrin të shpjegojë dukurinë e totalitarizmit komunist" në përgjithësi në të tërë vendet, "dëshmitar i përvojës së vrazhdë, tragjike të regjimeve totalitare" në të gjitha kohërat. Trebeshina ka shkruar edhe romanin epike me 5 vëllime Kënga shqiptare. Vëllimi i I-rë i romanit, sipas shënimeve të shkrimtarit, përfundoi në vitin 1951, ndërsa i fundit më 1966. Duke u kthyer pas në kohë dhe duke analizuar zhvillimin letrar të kësaj periudhe, bindemi plotësisht se vepra është shkruar në ato dhjetëvjeçar, sepse mban brenda vetes priren letrare të saj.

"Kënga shqiptare" është kënga e bukurisë së natyrës dhe e bukurisë së shpirtit njerëzor. Ajo, gjithashtu, është kënga e mbijetesës ekonomike, e punimit të tokës dhe mos prodhimit, ca nga prapambetja teknike, e ca nga fatalizmi i natyrës mes thatësisë e përmbysjeve, por është dhe kënga e mbijetesës në një vend ku paragjykimet e tradita nuk e lënë shpirtin e lirë të zgjedhë lirisht.

Pas viteve '90, filloj dhe botimi e vënia në skenë e dramave të Trebeshinës. Dramaturgjia e Trebeshinës, duke u nisur nga struktura formale dhe tematike, shfaq elementë të qartë ngjashmërie me dramën e absurdit dhe paradoksit zhvilluar në Evropë veçanërisht në vitet 50-60 të shekullit XX me përfaqësues Beketin, Joneskon, Pirandelon, por që nuk njiheshin në Shqipëri gjer vonë. Trebeshina, është një nga themeluesit e dramës moderne shqiptare, duke u nisur jo vetëm për nga dallueshmëria me traditën shqiptare, por edhe krahasuar me përfaqësuesit kryesorë të dramës moderne botërore. Ai tashmë është pjesë e padiskutueshme e traditës më të mirë letrare në shqip. Ndonëse mbetet akoma, i pareaalizuar amaneti i shkrimtarit, botimi i plotë i dorëshkrimeve të tij.

*Titujt janë redaksionalë

DPSHTRR: Detyrimet që fshihen, si të kryeni verifikimin nga targat

Ornela Manjani

Drejtorja e Shërbimit të Transportit Rrugor ju kujton drejtuesve të mjeteve që kanë detyrime të pashlyera se kanë afat deri në 31 dhjetor për të përfutur nga amnistia...

Amnistia për makina, afati deri në 31 dhjetor

Janë 140 mijë automjete që përfitojnë nga falja

ndiqen deri më datë 31 dhjetor 2017. Brenda datës 31.12.2017, njoftohen të gjithë qytetarët që të përfitojnë nga procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/

shuarjes së detyrimeve. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka publikuar dhe azhurnuar listën e mjeteve objekt i ligjit 33/2017, ku të gjithë personat e interesuar

mund të bëjnë verifikimin e targës dhe karakteristikave të tjera të mjetit në këtë listë. Subjektet e personat përgjegjës të paraqiten pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transpor-

tit Rrugor për të kryer pa pagesë, veprimet e heqjes nga qarkullimi të mjetit apo për të kërkuar shkëputjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi dhe mbajtjen aktiv të tij.

FSHIRJA E DETYRIMEVE Subjektet që duan të mbajnë mjetin në qarkullim u fshihen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave për mospagesë së taksave të periudhës janar 2011 deri në dhjetor 2014, të cilat kushtin/shuhën me kushtin e pagesës së të gjitha detyrimeve të plota, thuhet në njoftim DPSHTRR.

TARGAT E MJETEVE QË KANË DETYRIME TË PASHLYERA

Table with 12 columns of license plate numbers (TARGA) and their corresponding vehicle identification numbers (VIN).

Opinion i Ditës

Nga një, në tre dhe rëndësia e marrëdhënieve SHBA-Rusi-Kinë

Nga Vasil Kureta

(Vijon nga faqja e parë)

...të shtuar e marrëdhënies mes tre të mëdhenjve, sa i përket rolit të tyre në qeverisjen botërore. Pas rrëzimit të komunizmit, u konstatua se SHBA ishte superfuqia e vetme botërore, e cila realizoi përgjegjësitë e saj, sa i përket garantimit të sigurisë e stabilitetit të rendit botëror. Shpejt SHBA ndjeu nevojën e kontributit edhe të aktorëve të tjerë në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, teksa u formula në dy mandatet e presidentit të SHBA, Obama në formën se, SHBA është superfuqia e vetme botërore, por që ajo nuk mund të plotësonte e vetme përgjegjësitë në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar e faktorëve të tjerë globalë kërcënues të tij, pa kontributin e bashkëpunimit me aktorët e tjerë të rëndësishëm.

Ishte kjo nevojë realiste, por edhe një vështrim konkret i zhvillimeve ndërkombëtare, ku konstatohet qartë zhvillimi më intensitet i ambicieve për superfuqi botërore e prirje për të ndarë fuqinë e rolin me SHBA, të dy aktorëve të tjerë si Rusia dhe Kina. SHBA me të drejtë insistoi në respektimin e ligjit të së drejtës ndërkombëtare në zhvillimin e ambicieve të superfuqisë së këtyre aktorëve, si në rastin e aneksimit të Krimesë dhe shpërthimit i konfliktit në Ukrainë etj., për Rusinë, por edhe me lëvizjet e Kinës me ishujt artificialë e forcimin e dispozitivit ushtarak në rajonin e Azisë, Paqësorit etj., por duke i mbajtur të hapura kanalet e dialogut e diskutimit me të drejtëpërsëdrejti, por edhe në organizim ndërkombëtarë si OKB e Këshilli i Sigurimit, por edhe në formatet të tjera e samite me pjesëmarrje të gjerë.

Kur presidenti i ri amerikan, Trump bëri publik tezën "Amerika First", analistë të ndryshëm nuk nxituan të bënin interpretime, edhe pse pati ndjeshmëri të lartë, si ndaj kritikave të presidentit amerikan për Aleancën Euroatlantike e BE, për marrëveshjen tregtare me Kinën, apo edhe për angazhimet konkrete të SHBA, siç ishte ai lidhur me krizën siriane, me marrëveshjen për klimën etj. Pati ndonjë analist që e interpretoi këtë tezë jo vetëm si një formë të nacionalizmit amerikan, por edhe si një lloj tërheqjeje apo lëshimi i disa përgjegjësi nga SHBA për zhvillimet botërore edhe si pasojë e efekteve të krizës botërore financiare etj. Disa menduan të presin, nëse ndodhemi përballë një doktrine të re amerikane, që do të shfaqë në proces elementët e saj. Shpejt u rrit interesimi për të kuptuar më shumë ndaj qëndrimit të SHBA në zhvillimet botërore dhe ndjeshmëria ndaj sjelljes së SHBA-ve ndaj këtyre zhvillimeve, teksa u panë deklarime që flasin për pritshmëritë e takimeve direkte të presidentit Trump me Putin dhe Xi Jinping. SHBA, duke filluar që nga fundi i presidencës Obama, filloi një tërheqje nga angazhimi, apo



sendërtimi i statusit si superfuqia e vetme, që linte të kuptohej se, e vlerësonte avancimin e statusit të superfuqisë nga Rusia dhe Kina në zhvillimet botërore, me të cilat duhet të dialogonte me to, sa i përket ndarjes së rolit e fuqisë. Ajo që lexohet në këtë fazë, sa i përket mbushjes së marrëdhënieve mes këtyre tre aktorëve kryesorë, tregon se po bëhet, apo është bërë kalimi nga një në tre superfuqi botërore në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Pritet të ketë në këtë zhvillim edhe kontradiktat, dallime në interesa konkrete gjeostrategjike, edhe dialog, marrje e ndarje të përgjegjësiave, apo edhe nxehtë e tensionim të situatës mes tyre, por edhe detanta e kontribute, marrëveshjeje e traktate mes tyre apo me pjesëmarrje më të gjerë. Rëndësia, pritshmëria, dobishmëria e përmbytjes dhe cilësisë së marrëdhënieve mes këtyre fuqive të mëdha është dhe do të bëhet më e madhe.

Realizimi i rolit botëror do të mundësohet mbështetur në interesa konkrete gjeostrategjike, ku dallimet janë e do të jenë më të qarta. Kuptohet pesha e interesave konkrete, por këtu rëndësi të veçantë ka e do të ketë kontributi konkret e përgjegjshmëria e lartë ndaj zhvillimeve të qëndrueshme, ndaj sigurisë, paqes e stabilitetit. Në sendërtimin e marrëdhënies së re mes tyre, rol tepër të veçantë do të ketë nevoja e kuptimit, vlerësimit e materializimit të standardeve e principeve konkrete, ku përvoja e SHBA, përfshi edhe metodologjia e realizimit të rolit të përgjegjësiave, ka vlerë të veçantë.

SHBA e ka realizuar rolin dhe kontributin e saj duke u mbështetur në dy shtylla kryesore: mbrojtja e ligjit e të drejtës ndërkombëtare dhe referimi të sistemi i vlerave, shoqëruar me harmonizimin e bashkëpunimit me aktorë të tjerë ndërkombëtarë. Raporti ndaj këtyre dy shtyllave do të ndikojë ndjeshëm në përcaktimin e cilësisë së marrëdhënieve dhe do të evidentojë kontributin e tyre konkret në zhvillimet e qëndrueshme botërore. Nuk pritët një marrëdhënie e lehtë, prandaj dhe çdo lëvizje do të prodhojë lajm, pritshmëri e ndjeshmëri të lartë, lëndë konkrete zhvillimi dhe pasoja direkte në zhvillimet botërore.

Nuk ka dyshim se po ravijëzohet një ndryshim i madh, jo thjesht në formë, por në përmbytje, që do të pasurojë cilësinë e modelit të ri të sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare, në periudhën e re pas rrëzimit të komunizmit. Këtu vëmendje e rëndësi të veçantë ka fakti që SHBA, realizimin e saj të rolit të superfuqisë së vetme botërore, e ka mundësuar si Perëndim, përfshi, vendet e BE, aleatët euroatlantike dhe NATO, duke qenë realisht udhëheqësja e Perëndimit. Për këtë arsye tërheqin vëmendjen marrëdhënia brenda hapësirës perëndimore dhe kritikën e presidentit Trump, si ndaj NATO-s, por edhe BE-së. Ka për të interpretime të ndryshme, që kanë brenda një shqetësim të drejtë, si për kontributin real të SHBA-ve, por edhe hapësira që mund të krijohet për aktorët e tjerë ndaj pjesës europiane të Perëndimit.

Ka tashtëmëdithe mendime se

er krizën dhe sfidat reale. Po kështu, BE po vepron drejt për mbrojtjen e sistemit të vlerave, siç dëshmoi dhe samiti i fundit i Goteborgut, modelit të ngritur mbi të dhe duke mbështetur globalizmin. Kjo filozofi europiane mundëson fokusimin në sigurimin e mundësive të barabarta dhe qasjen në tregun e punës, synon kushte të drejta të punës, si dhe mbrojtjen sociale. Këto hapa sfidojnë qartë dhe kritikën e atyre që mendojnë se BE përfaqëson një klub elitash kapitaliste neoliberalë. Megjithatë, BE ka sfida të mëdha përpara, por ka një filozofi të drejtë të orientimit nga mbrojtja e sistemit të vlerave dhe elementëve thelbësorë të aleancës euroatlantike. Sa më shpejt, BE të përballojë sfidat, aq më mirë do të jetë për realizimin prej saj të një kontributi konkret ndaj stabilitetit e sigurisë së rendit botëror dhe përballimit të synimeve e orekseve konkrete imperiale, apo objektive gjeostrategjike të të tjerëve ndaj saj. Stabiliteti, siguria dhe pagja në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare kanë pasur dhe kërkojnë një cilësi e përmbytje më të pasur edhe në kontributin e vendeve të BE.

Në këto kushte, kur dhe po kryhet procesi "Brexit" vjen një deklaratë e kryeministres britanike May, që akuzon Moskën për ndërrhyrje në zgjedhje, se kryen spiunazh kibernetik dhe se përpjet të dëmtojnë shoqëritë e lira. Ajo i kërkon Putinin të respektojë sistemin e vlerave dhe ligjin ndërkombëtar. Kryeministria britanike, duke iu referuar historisë së marrëdhënieve me Rusinë, pohon se rusët krijojnë histori të rreme për të shkakuar mosmarrëveshje me Perëndimin. Ajo theksoi vendosmërinë për të mbrojtur interesat e vendit të saj, edhe pse nuk kërkon një përballje me Rusinë. Ajo, jo rastësisht i kujtoi Putinin aneksimin e Krimesë, nxitjen e konfliktit në Ukrainë, si dhe sulmet kibernetike ndaj qeverive e parlamenteve në Europë.

May përcilloi mesazhin e qartë se, Britania nuk pajtohet me orekset imperiale të Rusisë dhe shkeljet e ligjit ndërkombëtar. "Unë kam një mesazh shumë të thjeshtë për Rusinë - ka nënvizuar ajo - e dimë se çfarë po bëni dhe nuk do të keni sukses. Ju nënvlehtësoni rezistencën e demokracive tona, mbështetjen e fortë që kanë shoqëritë e hapura dhe angazhimin e vendeve perëndimore ndaj vlerave që na bashkojnë". Duke shprehur angazhimin e plotë në NATO, mbështetjen e sistemit të vlerave e demokracisë liberale, kryeministria britanike theksoi se, një praritet i fortë ekonomik mes BE dhe Britanisë do të ishte një mburojë ndaj trazirave që Rusia shkakton në Europë. "Ne nuk duam të kthehemi në luftën e ftohtë", ka saktësuar May. Është e kuptueshme që Rusia ka interesa gjeostrategjike ndaj hapësirës europiane, apo interesa imperiale, siç i kualifikojnë disa analistë. Këtë e dëshmojnë lëvizje komplekse në shumë fusha dhe një retorikë akuzuese e Rusisë ndaj NATO-s, që lëvizjet e saj në mbrojtje të aleatëve, që ndjehen të kërcënuar nga Rusia, i kualifikon si synime për të rrethuar Rusinë apo si shkelje të mar-

Dje në 'Deutsche Welle'

Nga Ines Pohl

(Vijon nga faja e parë)

...edhe për mundësinë e zgjedhjeve të reja. Indes Pohl nga Berlina.

Pas Brexit, Donald Trump tani edhe kjo, Angela Merkel, të paktën aktualisht, nuk ia doli të krijojë një qeveri të re. Në një Gjermani të fortë, kaq të suksesshme në zemër të Europës, në motorin e BE-së, ende nuk dihet më shumë se 8 javë pas zgjedhjeve të Bundestagut, se si do të zhvillohen gjërat. Pak para mesnate, kreu i partisë liberale, FDP Christian Lindner bëri të ditur dështimin e bisedimeve.

Sipas motos, më mirë asnjë koalicion, se sa një koalicion i gabuar. Kësaj i paraprinë negociatat të vështira në një konstelacion të mundshëm qeveritar, i cili që nga fillimi kishte si synim aleancën e interesave dhe jo martesën nga dashuria. Një konstelacion që deri në fund u fiksua nëpër detaje, dhe nuk që në gjendje që nga dallimet mes partive të krijonte një vlerë të shtuar të përbashkët.

AFD NË PARLAMENT

Për herë të parë u fut në parlament një parti konservatore e djathtë, duke i trazuar ndjeshëm mundësitë e koalicioneve. Në një parlament tanimë të përfaqësuar nga shtatë parti nuk ka zgjidhje të thjeshta. Refuzimi i hershëm i SPD-së për koalicionin e madh me konservatorët, bëri që Kancelarja Merkel, tanimë prej 12 vitesh në pushtet, të hynte në bisedime të mundshme koalicioni, ku që në fillim nuk kishte ndonjë pozicion të pushtetshëm. Megjithatë ajo përfaqëson partinë më të fortë. Por një parti të dobësuar nga rezultati i dobët i zgjedhjeve. Kështu roli që i mbeti Angela Merkelit ishte vetëm ai i ndërprerjes së, e me këtë ajo dështoi.

Me sa duket ishte FDP-ja, ajo që e pengoi Merkelin të gjente një narrativ të ri, një ide për një ale-

ancë qeveritare, që nuk ishte e sprovuar më parë. Por që me guxim e me ide të reja, kjo aleancë mund të formësohe në mënyrë aktive realitetet e reja politike.

NË FOKUS POLITIKA E REFUGJATËVE

Në qendër të konfliktit qëndroi politika ndaj refugjatëve. Politika liberale e Merkelit solli forcimin e

AFD-së. E në fund kjo solli edhe dështimin e qeverisë së re. Por kjo nuk është ndonjë provë se ishte veprim i gabuar të ndihmës njerëzore në nevojë. Por një provë për atë, se nuk u arrit që mbështetja për të tjerët të mos bëhej kërcënim për vetjakën. Dështimi i krijimit të qeverisë tregon se edhe Gjermania ndodhet tani para kthesës. Dhe se

suksesi ekonomik nuk ua heq njerëzve frikën para një të ardhmeje, ku refugjatët kthehen në një fushë projekioni për pasiguri të botës së globalizuar. Zgjimi i së hënës nuk është vetëm për Gjermaninë një shok, por për të gjithë Europën, sepse para nesh qëndrojnë jo vetëm javë, por muaj pasigurie.



© picture alliance/dpa/B. von Jutrc

← rëveshjes NATO-Rusi etj. Kjo retorikë zhvillohet në një kohë kur është krijuar dyshimi ndaj SHBA, nisur nga kritikë të adresuara nga Trump ndaj BE-së edhe për çështje të sigurisë, që Rusia do të përpiqet ta ushqejë e të përfitojë sa më shumë. Jo rastësisht Rusia së fundi flet për politikë përjashtuese të NATO-s kundër Rusisë. Sipas Rusisë, vendet perëndimore kanë zgjedhur një politikë të sigurisë të mbyllur dhe të përqendruar në NATO, duke vazhduar në këtë mënyrë doktrinën "Truman" të përjashtimit. Moskë akuzon NATO-n se vazhdon "mitin" e kërcënimit të ardhur nga lindja. Po kështu, duke iu referuar antarësimit në NATO të ish-vendeve socialiste, Rusia flet për pasojë të drejtpërdrejta të rritjes së konfliktualitetit në zonën euroatlantike. Madje, ka përpjekje për të përcjellë idenë se tash po kalohet nga një Perëndim i bashkuar, në një Perëndim të ndarë. Retorika e lëvizjet konkrete komplekse të Rusisë ndaj hapësirës së BE janë dëshmi e objektivave konkrete të Rusisë në funksion të mundësitë të konsolidimit të statusit të superfuqisë botërore, ku

një rol i saj në hapësirën europiane është element thelbësor. Pas kapërcimit të një krize reale që kalon BE, do të pritet dhe një qëndrim i unifikuar i BE ndaj synimeve reale të Rusisë. Samitet e fundit të APEC dhe të ASEAN sollën argumente më shumë në favor të tezës se tash do të ketë një raport tjetër mes SHBA, Kinës dhe Rusisë, sa i përket rolit të kësaj tresheje në qeverisjen botërore. Problemet ekonomike e tregtare, por edhe tri krizat aktuale si ajo e Ukrainës, kriza siriane e më gjerë në Lindjen e Mesme dhe kriza e Koresë së Veriut do të shërbejnë si guri i provës së cilësësi së marrëdhënies së re, midis tri fuqive të mëdha, ku do të shfaqet edhe përplasje e interesave gjeostrategjike e politike, për zonat e influencës, por edhe fushat e mundësitë e bashkëpunimit, edhe dialogu, por edhe rivaliteti e tensionet. Në fjalën e tij në samitin e APEC, presidenti Trump përcolli atë që cilësohet një politikë e re në Azi, tekta nënvizoi tezën "në rajon i lirë dhe i hapur në Azi-Paqësor", që ka tash edhe kritikët konkretë dhe që pritet të konkretizohet e se si do të funksionojë në

raport me partnershipin Trans-Pacifik (TPP), pra në një rajon që siguron 40% të GDP botërore. Në samitin e ASEAN-it, presidenti Trump shpalosi vizionin e SHBA në këtë rajon, që merr në konsideratë problematikën kontraktore, por edhe të ardhmen, në kushtet e ndryshimeve të rëndësishme në sistemin e marrëdhënies ndërkombëtare. Si pjesë e këtij vizioni, Trump nënvizoi se SHBA dhe Kina janë dy ekonomitë më të mëdha dhe kontribuues kryesore në rritjen ekonomike globale dhe për këtë arsye është e nevojshme të punojmë së bashku për të ndihmuar zgjidhjet e problemeve botërore. Edhe një version i ri i TPP bëhet kështu dëshmi e vizionit të ri amerikan. Pritet një marrëdhënie e re, që do të përfshijë bashkëpunimin dhe konkurrencën, që disa analistë e vlerësojnë si një model i ri bashkëpunimi SHBA-Kinë, mjaft pozitive, jo vetëm në Azi-Paqësor, por edhe në rang botëror. Siç pritet, Trump iu referua dhe marrëdhënies me Rusinë dhe rolit të saj në zhvillimet botërore. Ai ka theksuar se Moskë mund të ndihmojë në

zgjidhjen e krizave në botë dhe se raportet pozitive me Rusinë janë një gjë e mirë. Në formë pyetjeje, ai përcolli mesazhin se, "kur do ta kuptojnë kundërshtarët tanë, se të pasurit e marrëdhënies të mira me Rusinë është një gjë e mirë?". Madje, në mënyrë autokritike ka pohuar se Rusia është sanksionuar shumë dhe se tani është koha të shërojmë një botë të shembur dhe të thyer. Duhet pritur e nuk duhet nxjatur e paragjykuar. Ka qaq shumë probleme e kriza të rënda, që rrezikojnë maksimalisht sigurinë e paqen në botë, që rrezikojnë ekzistencën e njerëzimit. Papa Françesku, i shqetësuar për këtë situatë, ka deklaruar: "Bota po i drejtohet një lufte edhe më të madhe se ato të mëparshmet... Sot bota është në luftë dhe po bëhet gati të hyjë edhe më e fuqishme në luftë... Me luftën humbet gjithçka". Ky shqetësim është më se i drejtë, se një luftë e mundshme botërore do të lërë pas vetëm "kufoma në kalbëzim" e "gërmadha në tym", do të lërë vend ndoshta vetëm për milingonat, se njerëzimi në tokë kështu zhduket.

Më 19 nëntor 2017

HOROSKOPI

DASHI
Nevoja për siguri vjen në një kohë pak të ndërlikuar për jetën në çift. Vendosi të gjitha letrat mbi tavolinë dhe dorën në zemër. Të shprehni emocionet tuaja nuk do të jetë e lehtë, por të paktën e keni provuar. Dhe kjo është ajo që ka rëndësi.

DEMI
Të pavarur dhe me zgjuarsi, do të dini si ta ktheni situatën në avantazhin tuaj. Në fund do të merrni rezultate edhe më të mira sesa kishit parashikuar. Askush nuk do t'ia dalë t'ju pengojë dhe të ndërhyjë midis jush dhe objektivave tuaja.

BINJAKET
Energjia e Marsit do t'ju nevojitet së tepërmi në botën e sipërmarrjes. Do t'ju ndihmojë gjithashtu të kanalizoni më mirë energjitë, në mënyrë që të ngriheni. Durimi shpërblehet, por në këtë rast nevojitet mbi të gjitha vullneti, që sidoqoftë nuk ju mungon.

GAFORJA
Luftoni kundër vështirësive emocionale që ju ka sjellë pozicionimi i Venusit me Saturnin, duke e marrë jetën pak lehtë dhe me një buzëqeshje. Nëse lexoni ligjet e zemrës, do ta kuptoni se jo gjithmonë "fluturohet", do të lodeshit shumë.

LUANI
Miq në vështirësi? Jeni gati të bëheni copa për të ndihmuar dhe për të kënaqur gjithkënd. Por për veten ndërkaq, keni prirje të mendoni shumë pak. Nëse koha nuk ju mjafton, nuk mund të bëni gjë tjetër përveçse të zgjidhni me shumë kujdes angazhimet tuaja.

VIRGJERESHA
Keni ndryshuar mendje ndoshta shumë shpejt dhe tani një kolegu i ka mbetur qejfi, duke u njozër i tradhtuar. Sigurisht që do t'ia dini të shpejtëgjatë me mirë. Duhet disa pikëmbështetje të forta, për të mos lejuar të tërhiqeni lehtësisht nga çdo drejtim i rrymës.

PESHORJA
Po prisni për të gjetur momentin e duhur për të dalë e për t'u dëfryer me të dashurit tuaj. Pak ajër i freskët bën mirë gjithmonë. Dikush shumë shpejt do t'ju shprehë të gjithë mirënjohjen e vet, pasi ju nuk i gjykonin gjërat nga paraqitja.

AKREPI
Më e mira pritet të vijë. Kjo është ajo që thoni shpesh nën zë me veten, duke e ditur se gjithmonë mund të përmirësoheni dhe se të kënaqeni me pak nuk është diç që ju shkon përshat. Ndërsa prisni mundësinë për të bërë lëvizjen e duhur, planifikoni çdo strategji deri në hollësi.


SHIGJETARI
Së shpejti megjulla do të fashitet dhe ju do të shihni çdo gjë më qartë. Tani për tani nuk mund të bëni gjë tjetër, përveçse të prisni, pa ndërmarrë hapa të rrezikshme. Nuk është e vështirë të kujdesesh për diçka, nëse e doni vërtet. Fillimisht fitoni utesinë.

BRICJAPI
Duke mësuar të menaxhoni pengesat, jo vetëm që do të vlerësoheni nga të gjithë, por do t'ju besohen edhe detyra të reja së shpejti. Nëse jeni duke kërkuar një ndërmarje të re, duhet të jeni ju të parët që besoni në potencialet tuaja.

UJORI
Rastësi të vogla do t'ju ndihmojnë ta zëroni vonesën që keni akumuluar. Kështu, në fund do t'ia dini dhe para të tjerëve. Nuk keni si të mund të mos shmangni ndonjë vështirësi pak miqësore në rrethin tuaj, por do t'ia dini t'i pranoni.

PESHQI
Disa angazhime të rëndësime nuk ju lënë kohë që t'i realizoni planet ashtu si dëshironi. Fatkeqësisht askush nuk duket i gatshëm t'ju ndihmojë. Por, do t'i kryeni detyrat edhe të vetëm, madje në mënyrë që të mirë të mundshme. Një fjalë e urtë thotë: "I zotë e nxjerr gomarin nga balta".

PËRZGJEDHJA



6 lojtarë të Barcelonës dhe 3 të Realit të Madridit në 11-shen më të mirë të shekullit të 21-të. UEFA ka zbuluar formacionin më të mirë të këtyre 17 viteve të fundit në futboll dhe ndër të përzgjedhurit e tifozëve, të cilët me votat e tyre kanë zgjedhur 11-shen më të mirë, spikasin Barcelona


UEFA përcakton 11 më të mirët e shekullit të 21-të

dhe Realin e Madridit, me blaugranat që bëjnë ligjin me plot 6 lojtarë. Në portë është zgjedhur Iker Casillas për atë çfarë ka dhënë me Realin e Madridit pasi aktualisht gardiani spanjoll është pjesë e Portos. Mbrojtja përbëhet nga ish-kapiteni i

Bayernit, Philip Lahm, ish-qendërmbrojtësi i Barcelonës Carles Puyol, por edhe nga dy më të mirët e momentit në pozicionet e tyre, Gerard Pique dhe Sergio Ramos. Kabina e regjisë në mesfushë i përket një ish-katalanasi, pikërisht Xavi-t i

mbështetur nga Iniesta dhe Gerard. Në sulm përkrah Messit dhe Ronaldos, fansat që kanë marrë pjesë në votim kanë preferuar edhe francezin Thierry Henry, i cili më shumë sesa për paraqitjet e tij me Barcelonën, është vlerësuar për periudhën fantastike të karrierës së tij me Arsenalin.

ISH-PRESIDENTI I FEDERATËS



Tavecchio: Pagova unë, por Venturën e zgjodhi Lippi

Disa orë pasi dha dorëheqjen si president i FIGC-së, Carlos Tavecchio u rikthye të flasë sërish. Edhe këtë herë, ish-presidenti i Federatës Italiane të Futbollit u shpreh se po paguan paafësinë e Venturës, por ndryshe nga herët e tjera, u shpreh se këtë të fundit e kishte zgjedhur Marcelo Lippi. "Është e vërtetë, që po paguaj gabimet e Venturës dhe atë shtyllë që na mohoi golin në Solna. Çfarë duhet të kisha bërë? Të shkarkoja Venturën në përfundim të pjesës së parë në Milano? Gjithmonë kam thënë që e kam zgjedhur unë trajnerin, por sot jo. Dua t'u tregoj se, ashtu siç e tha edhe Malago, Venturën e zgjodhi Marcelo Lippi", tha i mërzhitur Tavecchio.



Rikthehet fuqishëm Partizani. Të kuqtë bënë goditjen e madhe pasi triumfuan me rezultatin 2-1 brenda në "Zeqir Ymeri" përballë Kukësit, duke u rikthyer te fitorja në kampionat pas 3 humbesh radhazi. Ky ishte sukcesi i parë për Sulejman Starovën me 15-herë kampionët në këtë sezon, ndërkohë që pas kësaj humbjeje pozicioni i serbit Mladen Milinković në stolin e Kukësit lëkundet ndjeshëm me ish-trajnerin e Luftëtarit që rrezikon shkarkimin. Në Kukës sfida nisi mirë për vendasit që kaluan në avantazh me një penallti të kthyer në gol nga Guri në minutën e 8-të. Protesta të shumta të Sulejman Starovës ndaj gjyqtarit Andi Koçi për 11-metërshin e akorduar për një faull të Atandës ndaj Kale brenda zone, me arbitrin që u detyrua të largonte nga fusha trajnerin e Partizanit me karton të kuq. Por nuk vonoi shumë dhe Partizani gjeti golin e barazimit. Në të 21-tën Bardhi përfitoi nga një top i mbetur në zonë pas devijimit të Malotës që ishte i dyshimit pasi mbrojtësi edhe mund ta ketë prekur topin me dorë, për të mposhtur Frashërin. Në sekondat e fundit të pjesës së parë Partizani gjeti edhe golin e epërsisë me ishin Gerhard Prog-

Të kuqtë pësojnë gol në minutën e shtatë, por përmbysin gjithçka në pjesën e parë

Partizani trondit Kukësin
Luftëtari nuk di më të fitojë

Milinković rrezikon stolin e kampionëve



ni. Bardhi përfitoi nga gabimi amatoresk i Albi Allës duke servitur Prognit asistin e golit të 1-2. Në pjesën e dytë Kukësi luajti më mirë, por shtylla i mohoi golin e barazimit Guri në minutën e 72-të. Deri në fund në "Zeqir Ymeri" nuk ndryshoi më asgjë me Partizanin, që u ngiit në kuotën e 14 pikëve pas kësaj fitoreje, ndërsa Kukësi tashmë zbrit në vendin e 3-të në kuotën e 19 të tillave.

Kristal Abazaj në fillim dhe Gjoni në fund. Ndeshja në Gjirokastër mes Luftëtarit vendoset në ekstreme me dy gola që përshkruajnë më së miri një 90 minutësh shumë të luftuar në "qytetin e gurtë". Ashtu si në fazën e parë Abazaj shënoi një gol në minutën e dytë, por nuk arriti të ishte vendimtar ashtu si tre muaj më parë në Kurbin. 90 minuta intensive, dyluftime për çdo top dhe shumë intensitet

dhe raste në të dyja portat, por në fund ishte Gjoni ai që konkretizoi me gol rastet e shumta të laçianëve. Klas i pastër i sulmuesve të skuadrës gjirokastrite që kaluan menjëherë në avantazh pas një kombinimi perfekt Bregu-Abazaj. Asnjë minutë pushim në këtë sfidë, sepse menjëherë pas rikthimit në fushë, Bregu nuk arriti të shënjestronë portën gjë që e bëri Bardhi, por gjeti regjimin e Ruçit. Ish-i Regginaldo me këmbët e rënduara nuk arriti ta shtynte topin në rrjetë, por në krahuin tjetër Abazaj nuk ia ktheu dot reston Bregut pasi Selmani kuptoi gjithçka. Laçi rriti presionin dhe brenda pak sekondave iu afrua ndjeshëm golit me Qaqin dhe Regginaldon, ndërsa Selmani hipnotizoi Bregun duke

i mohuar Luftëtarit golin e qetësisë. I sapofuturi Xhixha shkaktoi sërish drithërima në kampin gjirokastrit, por as ai dhe as Regginaldo nuk gjetën rrjetën ashtu siç bëri Gjoni 1 minutë nga fundi. Një ndeshje e pabesueshme që u mbyll me ekzekutimin pothuajse perfekt të Abazajt, i cili u ndal nga Selmani në superformë. Në fund, skuadra e Hasan Likës qan rastet e humbura, por ndoshta nuk pretendonte më shumë nga ky duel ku Laçi dhuroi një paraqitje vërtet pozitive. Gjirokastritët konsumojnë kështu një tjetër javë në shtëpi pa fitore duke bërë një hap të papërfillshëm në betejën e mbijetesës ku shkojnë në kuotën e 9 pikëve, ndërsa Laçi konfirmohet një nga skuadrat më në formë të momentit.

Igli Tare është shpallur "Drejtuesi sportiv i vitit" nga votimet e "TMW". Ish-futbollisti shqiptar, ka triumfuar në votimin e tifozëve, me një diferencë të thellë ndaj të gjithë ndjekësve. Ai ka marrë 34,99% të votave, me shumë se dy ndjekësit e tij më të afërt, Marko Xhianiti i Frozinones (13.7%) dhe Davide Vanjati i Spal (12.84%). Të shpikëputur janë emra të njohur si Mirabeli i Milanit, i 5-ti me 7,42%, apo Xhizuzepe Marota i Juventusit me 3,94%. Por vetë Tare, i kontaktuar nga "TMW", në mënyrë të papritur ia kushton këtë

Vlerësimi për shqiptarin
Igli Tare shpallet "Drejtuesi sportiv" i vitit



sukses trajnerit të Lacios, Simone Inzaghi, që e ka ndihmuar duke nxjerrë në pah potencialin e lojtarëve që ai ka afruar në skuadër. "Pa të gjithë komponentët, është e

pa mundur të arrish një rezultat. Duhet t'i bëj komplimente stafit tim, pastaj me Simone Inzaghi kemi fatin që jemi një grup, i cili punon bashkë prej më shumë se 12 vitesh. Kemi luajtur bashkë, pastaj ai është rritur në sektorin e të rinjve dhe tani është në ekipin e parë. Ai përfaqëson vlerat e klubit, skuadraluan një futboll entuziazmuës dhe meritat janë të gjitha të tijat".

Pas humbjes me Partizanin


Mbledhje urgjente te Kukësi, pritet "furtunë"



largimin e trajnerit Mladen Milinković. Burime brenda klubit bëjnë të ditur se presidenti Gjici nuk ka vendosur ende nëse do të shkarkojë apo jo teknikun, edhe pse është i pakënaqur nga rezultatet dhe nga disa zgjedhje të trajnerit. Ky i fundit, pritet që të tregojë në këtë analizë mendimet e tij për shkaqet e humbjes dhe të drejtojë gishtin nga lojtarët të cilët arsyetun

se nuk janë shprehur në nivelet e kërkuara, edhe pse para kamerave sot mori përgjegjësinë e mungesës së rezultateve mbi veten. Ndaj edhe nëse trajneri shkarkohet dhe bëhet "kokë turku" nesër, edhe lojtarët nuk do t'i shpëtojnë furtunës. Priten masa disiplinore dhe gjopa për ata, të cilët do të vlerësohen se nuk kanë dhënë maksimumin apo kanë gabuar duke dëmtuar ekipin. Sigurisht, një mënyrë aspak e qetë për të pritur një ndeshje të vështirë si ajo e fundjavës, në transferën ndaj Laçit ku në një fushë historikisht të vështirë, fitorja do të kthehet në detyrim.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Hari spiune.
4. Janë toksike.
9. Gjysmë arrest.
10. Janë vende pa ne.
13. Johnny i Donnie Brasco.
15. Priten nga meridianë.
18. Me të nxjerrin një letër.
20. U verbua nga Askushi.
21. Një britmë në arenë.
22. Shkrimtari i J'accuse.
24. Si moral.
25. Nota e diapazonit.
26. Me dies në një liturgji.
27. Një mund të jetë edhe veprimi.
28. Eshhtë e re pas Krishtit.
29. Inicialet e Bergman aktore.
30. Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.
32. Fise pa fe.
33. Një provë zjarri.

VERTIKAL

1. Fillojnë matanë.
2. Një Hans artist dadaist.
3. Eshhtë mjet rrethoror lundrimi.
5. Eshhtë ënjtje.
6. Lumi i Elizit.
7. Fillojnë mpirjen.
8. Eshhtë e gjithë Hëna.
10. Eshhtë qetësues për neurozat.
11. Taylor aktore.
12. Danieli i Robinson Crusoe.
14. Kështu janë skenat që mallëngjejnë.
16. Eshhtë pjesë në skenë.
17. Lëvizje Ekologjike Lokale.
19. Përshkohej nga Leti.
22. Eshhtë muzika më e... kollajtë.
23. Grazia Cucinotta aktore.
24. Veni pa ekstreme.
27. Janë tre në tricikël.
30. Scola, regjisor italian.
31. Kufizojnë një metër.
34. Mbahet me inat.
35. Mbyllin kurse.
36. Ka një shpejtësi fantastike.
38. Laik kur s'është ai.
40. Një liqen i kripur.
43. Një mund të jetë fetar.
44. Eshhtë lloj papagalli.
45. Në hyrje të sallës.
46. Priten në skaje.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Janë lokale me kubiste.
9. Me të nxjerrin në tapë.
11. Polanski regjisor.
12. Qeni i famshëm i Odiseut.
15. Mbeten në fund.
16. Gabon në ekstreme.
18. Rreh në kufij.
19. Eshhtë vepër për një... vepër.
23. Janë udhëtime për në një vend të shenjtë.
25. Dinë shumë gjuhë.
26. Një mendim.
27. Famëkeqj Capone.
28. Kush i kthen... të braktis.
29. Kisha pa zë.
30. I fejuari i kukullës Barbie.
32. Ritet pa re.
33. Një brinjë në skuadër.
35. Emri i Zola.
37. Eshhtë moshë e të miturit.

VERTIKAL


14. Lëvizin pasi mendohen shumë.
16. Janë sfera për bingo.
17. Eshhtë më pak se nxehtësi.
19. Gibson aktor.
20. Tregtonin skilevër dikur.
21. Mund të jenë fetare të tilla.
22. Kush nuk ka... nuk i ecën.
23. Një sherr në shtyp.
24. Një lidhëz.
25. Mund të jenë cigaresh.
29. Mund të bëjë zoom.
31. Ndërmarrje Industriale Mirditë.
33. Pak konkrete.
34. Eshhtë i mirë me shokë shumë.
36. Artikull për shumë francezë.
38. Kanto kur nuk... ka.
39. Muzika me jam session.
44. Mbyllin një sherr.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

P A P A S S K U L V E
A R A D M I N A T E G
R A E D I S O N E B R O
A R A T N T A S M A N
F A T K O P E R T I N E
I T M A T E R T A L E S
N P A R A R E N D E S I T
A A R T U R A T A V A
E G H A A T U S M J E T I
C I I N T L U L I T E K
K A P A C I T E T R O M E

FJALËKRYQI (2)

P E R V E N D I M E T
A Z O V D A D I L E M A
K O M E D I M I L A N E Z
P E R I O D I K E T E
T I T S A M A R I T A N E V
J K A M E R A M A N E V
E K C A D S I N T E Z A
G A L E N I H T A S R
U L A T B T E R O N T
L I G I T E R E N D E
L A K E M A R A I S E T
A R E N A N E M O T E R E

SUDOK

1	8			9		6			
		3	9	4	2				
5	4					2		7	
		6					5		4
9		5	7			1	3		8
8				9					2
2		7						3	6
				7	4	5	1		
			3		1			8	9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	7	5	8	6	4	3	9	1	
9	6	8	7	1	3	2	5	4	
3	4	1	9	5	2	6	8	7	
7	2	4	3	9	5	8	1	6	
1	9	3	6	4	8	7	2	5	
8	5	6	1	2	7	9	4	3	
5	8	9	4	7	6	1	3	2	
4	1	7	2	3	9	5	6	8	
6	3	2	5	8	1	4	7	9	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Asgjë nuk zvogëlohet aq sa suksesi. (Uolter Uincell)
- Sekret i suksesit është këmbëngulja për arritjen e qëllimit. (Benxhamin Dizraeli)
- Ka pak njerëz të rritur që nuk kanë qenë të suksesshëm që në fëmijëri. (Aleksandër Ceis)
- Bota u përket njerëzve entuziastë, që janë edhe gjakftohtë. (Uilliam McFi)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

9	1	2	4	16	17	17	18	50	IT	GA	
11	3	2	5	4	18	6	5	18	3	2	
9	6	9	9	10	2	18	2	1			
8	1	9	11	1	5	1	3	2	5	2	3
17	12	4	1	3	2	6	1	8	2	6	1
7	4	10	3	2	6	12	3	1	14		
13	6	12	5	2	3	9	4	1	11	6	18
14	6	2	4	9	1	4	10	1	1	12	
18	11	4	7	4	4	7	4	13	3		
2	6	7		3	1	10	6	6	2	2	
6	15	2	3	9	3	4	1	6	12	4	6
16	5	12	3	7	4	13	6	9	3	6	1

B	P	K	E	T	A	H	A	M		
G	O	D	A	R	D	R	R	E	Z	E
O	R	E	G	O	N	S	T	N	I	T
L	P	A	L	L	A	T	E	T		A
I	R	O	N	Z	E	R	I	E	L	
A	Z	E	T	A	M	I	L	E	T	I
T	I	T	R	K	A	A	S	I	K	
H	S	T	A	R	A	T	T	E	K	E
I	H	A	D	A	B	M	O	N	E	T
I	R	I	N	I	S	S	I	T		
A	R	G	A	T	N	A	T	N	A	P
P	A	T	A	R	A	D	H	E	T	A

Thënie të mënçura

- - Mos ndiq askënd... një person që të vlerëson ecën për krahu teje.
- - Në jetën tuaj do të jenë disa njerëz, që në një moment të caktuar do të bëhen shokët tuaj, dhe do të jenë disa shokë që në një moment të caktuar do të jenë thjesht shokë...
- - Pjekuri do të thotë të dish të bësh gjëra, për të cilat nuk na kontrollon askush: të kesh lekë në xhep dhe të mos i shpenzosh ato, të të bien në qafë dhe të mos duash të hakmerresh. (Anonim)
- - Një njeri s'mund të ndihet realist mirë, në rast se nuk aprovon vetveten. (Mark Tuein)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

Korça
 100-1000-1000
 100-1000-1000
 100-1000-1000



Tashmë edhe lundroni!

